



# MANUAL TRAJNIMI

## “PËRFSHIRJA E MËSIMIT PRAKTIK TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË PROGRAMET MËSIMORE”

Tiranë, 2019

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Financed  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



COUNCIL OF EUROPE

Implemented  
by the Department of Justice

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

## **MANUAL TRAJNIMI:**

### **“Përfshirja e mësimit praktik të të drejtave të Njeriut në programet mësimore”,**

Ky manual është hartuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në kuadër të projektit «Mbështetja e Mjeteve të Brendshme Efektive për Zbatimin e Vendimeve të GJEDNJ-së», zbatuar nga Këshilli i Evropës, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës.

Ky publikim është hartuar me fondet e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Idetë e shprehura nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjen zyrtare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

**Përgatitën manualin:** Kreu I - Oriona Mucollari, Kreu II - Nadia Rusi, Kreu III - Aurela Anastasi, Kreu IV – Adea Pirdeni.

Aneksi u përgatit në gjuhën shqipe nga Krisi Anastas

Përkujdesi publikimin: Kristina Jance

© 2019 Këshilli i Evropës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme ose përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çfarëdo sistemi depozitimi ose marrje informacioni, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

Tiranë, 2019

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare,

Adresa: Rr. Vaso Pasha, Pall.12, Shk.1/ap/1, Tirana, Albania

Tel: +355 672754655

Website: [www.qag-al.org](http://www.qag-al.org)

# PËRMBAJTJA E LËNDËS

## Kreu I

E drejta për të mos u diskriminuar, barazia gjinore dhe mbrojtja nga dhuna në familje në jurisprudencën e GJEDNJ-së..... 5

## Kreu II

Diskriminimi mbi bazë gjinie dhe dhuna gjinore.  
Nocione dhe Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ..... 17

## Kreu III

Procesi i rregullt dhe ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave (neni 6/1 i KEDNJ-së). Jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe mësimet për Shqipërinë..... 35

## Kreu IV

Afati i arsyeshëm si pjesë e procesit të rregullt ligjor: nocioni, jurisprudenca dhe ndryshimet ligjore..... 45

## Aneks

Një guidë e shkurtër për Artikullin 6 të KEDNJ-së, mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore..... 64

## Shkurtime:

GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
PNDCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
PNDESK	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KADNJ	Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut
KADNJNJ	Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Njerëzve
KADNJ	Karta Arabe për të Drejtat e Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese

# KREU I

## E drejta për të mos u diskriminuar, barazia gjinore dhe mbrojtja nga dhuna në familje në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

---

### 1.1 Përkufizimi i parimit të mosdiskriminimit

Virtualisht çdo instrument i të drejtave të njeriut përfshin një klauzolë jo-diskriminuese. Duke pasur parasysh se universaliteti i të drejtave të njeriut bazohet në premisën se të gjithë njerëzit janë të lindur “të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta”,<sup>1</sup> ndalimi i diskriminimit në gëzimin e këtyre të drejtave është i pashmangshëm. Ndërkohë disa instrumente përmbajnë një ndalesë të përgjithshme për diskriminimin, të tjerët kufizojnë ndalimin e diskriminimit në masën e nevojshme për të siguruar gëzimin e barabartë të të drejtave dhe lirive.

Dispozitat e mos-diskriminimit përgjithësisht bien në dy kategori. Disa prej tyre përcaktojnë se të drejtat e njeriut që kodifikohen do t’u garantohen të gjithëve pa diskriminim. Klauzola të tilla nuk janë të pavarura: ato mund të thirren vetëm në kombinim me dispozitat e tjera substanciale të instrumenteve ndërkombëtare. Të tjerë, përkundrazi, kanë një status të pavarur: ata mbrojnë nga diskriminimi në të gjitha fushat dhe jo vetëm në zbatimin e të drejtave të njeriut të listuara në instrumentet në të cilat ato shfaqen.<sup>2</sup>

---

1 Neni 1, DUDNJ

2 Oliver De Schutter, *International Human Rights Law, cases, materials, commentary*, Cambridge University Press, faqe.562.

Çdokush gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Deklaratë, pa dallim të çfarëdo lloji, si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendimi politik ose mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, pasuria, lindja apo ndonjë status tjetër;<sup>3</sup> gjithashtu Neni 2 (1) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP); Neni 2 (2) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK); Neni 14 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ); Neni 1 i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut (KADNJ); Neni 2 i Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Njerëzve (KADNJNJ); Neni 3 i Kartës Arabe për të Drejtat e Njeriut (KADNJ)<sup>4</sup> përcaktojnë pak a shumë përkufizime të ngjashme në lidhje me parimin e mosdiskriminimit.

Më specifikisht sipas Nenit 14 të KEDNJ – Ndalimi i Diskriminimit: “Gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Konventë, do të sigurohet pa diskriminim, për çdo lloj arsyeje si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, të shoqëruarit me statusin e pakicës kombëtare, pronës, lindjes, apo ndonjë status tjetër.”

Kjo mbrojtje e parimit të mosdiskriminimit, në rajonin evropian shoqërohet me të tjera standarte të garantuara në Konventë ose në Protokollat shtesë si më poshtë:

**Neni 8 i KEDNJ:** “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

**Protokolli 7 i KEDNJ, Neni 5:** “Bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësish të karakterit të së drejtës private midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj. Ky nen nuk do t'i ndalojë Shtetet që të marrin masa të nevojshme në interesin e fëmijëve.”

**Protokolli 12 i KEDNJ:** Protokollin nr. 12 parashikon një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit. Dispozita e tanishme e mosdiskriminimit e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e një lloji të kufizuar sepse ndalon vetëm diskriminimin në gëzimin e një ose të të drejtave të tjera të garantuara nga Konventa. Protokollin e heq

3 Neni.2, DUDNJ

4 Rhona K.M.Smith, Libër mbi Të drejtat Ndërkombëtare të Njeriut, Botimi i katërt, Oxford University Press, 2010, faqe 189

këtë kufizim dhe garanton që askush nuk duhet të diskriminohet në asnjë bazë nga ndonjë autoritet publik.

Ndalimi i diskriminimit, nenit 14 i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) është konsideruar gjithmonë si një dispozitë çuditëse. Ajo është përshkruar si një normë “parazitare”<sup>5</sup> dhe si “Hirushja” e Konventës,<sup>6</sup> dhe është thënë se qasja e Gjykatës ndaj saj mund të përshkruhet më së miri si “mërzitje”.<sup>7</sup> Shpjegimi kryesor për rolin vartës të Nenit gjendet në karakterin e saj ndihmës. Ndalimi i diskriminimit mund të thirret vetëm në lidhje me një nga të drejtat e tjera të mbrojtura nga Konventa. Që të jesh i mbështetur përpara Gjykatës, në rast të pretendimit për shkelje të nenit 14 të KEDNJ, një dallim në trajtim duhet gjithmonë të lidhet me një të drejtë tjetër thelbësore të Konventës. Nga ana tjetër, meqënëse e drejta thelbësore e Konventës zakonisht mund të thirret më vete dhe pothuajse çdo ndryshim në trajtim mund të trajtohet në këtë kontekst, ankesat për diskriminim shpesh nuk i shtojnë shumë pretendimeve të ngritura. Prandaj Gjykata në shumë raste vendos që të mos merret me ankesën e Nenit 14.<sup>8</sup>

Megjithatë, zbatimi i nenit 14 nuk supozon shkelje të njërit prej dispozitave thelbësore por kërkon vetëm që faktet në fjalë të bien brenda “fushës” së një ose më shumë dispozitave të Konventës.<sup>9</sup> Neni 14 nuk përshkruan një test të diskriminimit. Jurisprudenca ka sqaruar se dispozita ndalon trajtimet e ndryshme të individëve në situata të ngjashme vetëm nëse ka “një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv”<sup>10</sup> dhe trajtim të barabartë të individëve në situata shumë të ndryshme, përveç rasteve kur ka justifikim “të arsyeshëm dhe objektiv”. Në rastin e justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm kërkon që të ketë një qëllim legjitim dhe një “marrëdhënie të arsyeshme

5 Small, ‘Structure and Substance: Developing a Practical and Effective Prohibition on Discrimination under the European Convention on Human Rights’ (2003) 6 European Journal of Discrimination and the Law 45 at 47; and Baker, ‘The Enjoyment of Rights and Freedoms: A New Conception of the ‘Ambit’ under Article 14 ECHR’ (2006) 69 Modern Law Review 71 faqe 714.

6 O’Connell, ‘Cinderella Comes to the Ball: “Neni 14 dhe e drejta për mosdiskriminim në Konventë” (2009) 29 Legal Studies 211.

7 Goodwin, ‘Taking on Racial Segregation: The European Court of Human Rights at a Brown v. Board of Education Moment?’ (2009) Rechtsgeleerd Magazijn Themis 93 - 95.

8 S.H. dhe të tjerë v. Austrisë, Aplikimi No 57813/00, Merits and Just Satisfaction, 3 Nëntor 2011, parag.120; dhe V.C. v. Sllovakisë, Aplikimi No 18968/07, Merits and Just Satisfaction, 8 Nëntor 2011, parag. 176&80.

9 Në lidhje me interpretimin e testit “brenda fushës” shiko Wintemute, “Within the Ambit ” : How Big is the “ Gap ” Neni 14 i KEDNJ, 4 *EHRLR* (2004) 366.

10 Çështja e parë që përcakton një test është Rasti gjuhësor Belg, rast që lidhet me disa aspekte ligjore të përdorimit të gjuhës në Belgjikë(1968) Series A, No. 6.

të proporcionalitetit” ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimeve që kërkohen të realizohen.<sup>11</sup>

Në teori, të gjithë njerëzit janë të barabartë, sepse ata kanë të drejta të barabarta dhe këto të drejta duhet t’i gëzojnë të gjithë njëllëj. Në praktikë, shumë herë ndodh e kundërta. Barazia, si koncept, shpesh trajtohet si pasja e mundësive të barabarta (barazia formale), më shumë sesa pasja e rezultateve të barabarta, si dhe e eliminimit të barrierave apo mangësive ligjore, sociale, ekonomike, kulturore etj. Për të realizuar këtë qëllim (barazia substanciale). Në fakt barazia e vërtetë i përfshin të dyja.

### 1.2 Format e diskriminimit

Ata individë që janë në situata të ngjashme duhet të marrin trajtim të ngjashëm dhe të mos trajtohen në mënyrë më pak të favorshme thjesht për shkak të një karakteristike të veçantë “të mbrojtur” që ata posedojnë –diskriminim “të drejtëpërdrejtë”. Trajtimi, në disa situata, bazuar në rregullin në dukje neutral mund të jetë edhe diskriminim, nëse ajo shkakton disavantazhe për një person ose një grup personash si rezultat i karakteristikave të tyre të veçanta –diskriminimi”indirekt”.<sup>12</sup>

Njerëzit me prejardhje të ndryshme shpesh përballen me diskriminim të shumëfishtë, sepse të gjithë kanë një moshë, një gjini, një origjinë etnike, një orientim seksual, një besim sistemi ose fe; të gjithë kanë ndonjë gjendje shëndetësore ose mund të fitojnë aftësi të kufizuara. Asnjë grup i karakterizuar nga një karakteristikë e veçantë nuk është homogjen. Çdo person ka një model unik të karakteristikave, të cilat kanë ndikim në marrëdhëniet e tyre me njerëz të tjerë, dhe mund të përfshijë dominimin nga disa mbi të tjerët. Është e njohur gjithnjë e më shumë se adresimi i diskriminimit nga perspektiva e një karakteristike të vetme nuk arrin të kapë ose të trajtojë në mënyrën e duhur manifestimet e ndryshme të trajtimit të pabarabartë që njerëzit mund të përballojnë në jetën e tyre të përditshme.

**Diskriminimi i shumëfishtë:** Nuk ekziston një terminologji e vetme e përcaktuar – “diskriminim i shumëfishtë”, “diskriminim kumulativ”, “diskriminimi i përbërë”, “diskriminimi i kombinuar” dhe “diskriminimi ndërsektorial” shpesh përdoret në mënyrë të ndërsjelltë, edhe pse këto terma kanë ndikime paksa të ndryshme. Më

11 Ivana Radacic, Critical Review of Jurisprudence: An Occasional Series *Gender Equality* Jurisprudence of the European Court of Human Rights, The European Journal of International Law Vol. 19 no. 4 © EJIL 2008; all rights reserved. EJIL (2008), Vol. 19 No. 4 , 841 – 857 doi: 10.1093/ejil/chn044

12 Manual mbi: “European non discrimination law, European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Council of Europe, European Court of Human Rights, 2018 edition, faqe 42.



shpesh “diskriminimi i shumëfishtë” përshkruan diskriminimin që ndodh në bazë të disa karakteristikave/veçorive që veprojnë veçmas, ndërkohë që “diskriminimi ndërsektorial” nënkupton një situatë ku disa karakteristika/veçori veprojnë dhe ndërveprojnë sëbashku në të njëjtën kohë në mënyrë të tillë që ata të jenë të pandashëm<sup>13</sup> dhe prodhojnë lloje të veçanta diskriminimi.

Sipas GJEDNJ, si neni 14 i KEDNJ dhe Protokolli shtesë Nr.12 ndalojnë diskriminimin e bazuar në një numër të madh karakteristikash, duke e bërë të mundur teorikisht ankesën mbi disa karakteristika. Për më tepër, lista jo-shteruese e karakteristikave të diskriminimit i lejon GJEDNJ-së të zgjasë dhe të përfshijë karakteristika të pa përmendura shprehimisht. Megjithatë, Gjykata nuk përdor terma si diskriminimi i shumëfishtë ose ndërsektorial.<sup>14</sup>

Në çështjen N.B. v. Sllovakia,<sup>15</sup> lidhur me sterilizimin e detyruar të një grua Rome në një spital publik, kërkuesi shprehimisht u ankua që ajo u diskriminua në më shumë se një karakteristikë (raca / origjina etnike dhe seksi). GJEDNJ nuk bëri asnjë referim të qartë për diskriminimin e shumëfishtë. Ajo deklaroi, megjithatë, se “praktika e sterilizimit të grave pa pëlqimin paraprak ka prekur individë të pambrojtur nga grupe të ndryshme etnike”. GJEDNJ gjeti shkelje të Neneve 3 dhe 8 të KEDNJ.

Në raste të caktuara, praktikat gjithashtu do të bëjnë një dallim të hapur në bazë të formave të diskriminimit, duke ju munguar justifikimi i arsyeshëm dhe objektiv. Sidoqoftë, diskriminimi mund të rezultojë edhe nga përdorimi i kritereve, procedurave ose praktikave në dukje neutrale, efekti i të cilave do të jetë i ngjashëm me atë të diskriminimit të drejtpërdrejtë: atëherë ajo quhet diskriminim i tërthortë. Kriteret, procedurat ose praktikat e tilla, të cilat rezultojnë në diskriminim de facto, mund të llogariten me qëllim që të përjashtohen anëtarët e një kategorie të caktuar. Nga ana tjetër, edhe në mungesë të ndonjë qëllimi për të diskriminuar, ato mund të kenë një ndikim diskriminues, sepse ato janë rezultat i rutinave të vendosura dhe të pakontrolluara dhe nuk marrin parasysh situatën specifike të grupeve të caktuara.<sup>16</sup>

Duhet të theksohet, megjithatë, se të dyja llojet e diskriminimit çojnë në një trajtim të ndryshëm në situata të krahasueshme. Për shembull, një grua mund të përjashtohet

13 Komisioni Evropian (2007), “Tackling Multiple Discrimination. Practices, policies and laws”.

14 Manual mbi: “European non discrimination law, European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Council of Europe, European Court of Human Rights, 2018 edition, faqe 60.

15 GJEDNJ, N. B. v. *Slovakia*, No. 29518/10, 12 Qershor 2012. GJEDNJ, V.C. v. *Slovakia*, No. 18968/07, 8 Nëntor 2011.

16 Oliver De Schutter, *International Human Rights Law, cases, materials, commentary*, Cambridge University Press, faqe.625.

nga punësimi ose sepse punëdhënësi nuk dëshiron të punësojë gra (diskriminim i drejtpërdrejtë) ose për shkak se kërkesat për pozicionin janë formuluar në atë mënyrë që shumica e grave nuk do të jenë në gjendje t'i përmbushin ato (diskriminim i tërthortë). Në disa raste ndarja e mësipërme është më shumë teorike dhe mund të jetë problematike të përcaktohet nëse situata përbën diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.<sup>17</sup>

### Diskriminimi direkt do të ndodhë kur:

- ◆ një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme;
- ◆ krahasuar me mënyrën se si janë trajtuar apo do të trajtoheshin të tjerët, të cilët janë në gjendje të ngjashme;
- ◆ arsyeja për këtë është një karakteristikë e veçantë që ata mbajnë, e cila futet në kategorinë “karakteristika të mbrojtura”.<sup>18</sup>

Në zemër të diskriminimit të drejtpërdrejtë është trajtimi më pak i favorshëm që një individ i nënshtrohet. Kjo mund të jetë relativisht e lehtë për tu identifikuar krahasuar me diskriminimin indirekt, ku shpesh nevojiten të dhëna statistikore. Rrjedhimisht, tipari i parë i diskriminimit të drejtpërdrejtë është dëshmia në trajtimin e ndryshëm. Diskriminimi i drejtpërdrejtë gjithashtu mund të lindë nga trajtimi i dy njerëzve në situata të ndryshme në të njëjtën mënyrë. GJEDNJ ka deklaruar se “e drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara sipas KEDNJ-së, gjithashtu shkelet kur shtetet .... nuk i trajtojnë ndryshe personat situatat e të cilëve janë dukshëm të ndryshme”.<sup>19</sup> Trajtimi më pak i favorshëm mund të krijohet duke bërë krahasimin me dikë në një situatë të ngjashme. Ankesa për pagën “e ulët” nuk është një pretendim për diskriminim, përveç nëse mund të tregohet se paga është më e ulët se ajo e një personi të punësuar nga i njëjti punëdhënësi për të kryer një detyrë të ngjashme. Prandaj, për të përcaktuar nëse një person është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, është e nevojshme të identifikojmë një “krahasues” të përshtatshëm: domethënë, një person në rrethana materialisht të ngjashme, me dallimet kryesore midis dy personave që kanë “karakteristikat/

17 CJEU, C-267, 06, Tadao Maruko v. Versorgungsanstalt der deutschen Bühnen (GC), 1 April 2008, ku Avokati Ruiz-Jarabo Colomer dhe GJDBE arritën në përfundime të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

18 Joint reader, supporting the implementation of a course on “Legal protection against discrimination in Southeastern Europe”, editors: Ludwig Boltzmann Institute for Human Rights and South East European Law Schools Network, Authors: Antonija Petričušić, Ivana Grgurev, Oriona Mucollari, Zhaneta Popovska, Andjelija Tasić, Zlatan Meškić, Neda Zdraveva, Mario Vinković. Edition 1, ISBN: 978-3-200-06116-3, December 2018.

19 Thlimmenos v. Greece (GC), No.34369/97, 6 Prill 2000, paragrafi 44, Pretty v. United Kingdom, No.2346/02, 29 Prill 2002, paragrafi 88.

veçoritë e mbrojtura”. Provimi i një krahasuesi nuk duhet të jetë i diskutueshëm dhe gjithmonë i kërkuar dhe diskriminimi mund të provohet pa një diskutim të përmbyllës në lidhje me të.<sup>20</sup>

Proceduralisht, sipas KEDNJ-së, një aplikant duhet të jetë në gjendje të tregojë se ai ose ajo është “prekur drejtpërsëdrejti” nga masat që po ankohet, në mënyrë që të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë (statusi i viktimës).<sup>21</sup>

**Diskriminimi indirekt** sipas KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka nxjerrë këtë përkufizim në disa nga gjykimet e tij, duke theksuar se “një ndryshim në trajtim mund të marrë formën e paragjyqimeve jo proporcionale të një politike ose mase të përgjithshme e cila, megjithëse e shprehur në mënyrë neutrale, diskriminon një grup”.<sup>22</sup>

### Elementet e diskriminimit indirekt janë si më poshtë:

- ◆ një rregull, kriter ose praktikë neutrale;
- ◆ që ndikon një grup që përkufizohet nga “karakteristika të mbrojtura” në mënyrë të dukshme më negativisht;
- ◆ në krahasim me të tjerët në një situatë të ngjashme.<sup>23</sup>

Nocioni i diskriminimit indirekt shërben, pra, për dy qëllime të dallueshme: së pari, për të zbuluar raste të diskriminimit të vetëdijshëm që fshihen pas përdorimit të kriterëve dukshëm neutrale, për të arritur në të njëjtin rezultat që do të vijonte nga përdorimi eksplicit i kriterëve të ndaluara të diferencimit; së dyti, për të sfiduar disa rregulla ose praktika të cilat, megjithëse nuk llogariten për të prodhuar një efekt të tillë, imponojnë një disavantazh specifik në grupe të caktuara ose kanë një ndikim të shpërpjestuar në grupe të tilla, pa ekzistuar justifikimi për një disavantazh të tillë ose një ndikim të tillë. Në këtë konceptim të dytë, diskriminimi i tërthortë mund të jetë tërësisht i shkëputur nga çdo lloj synimi për të diskriminuar, dhe më së miri shihet si mjet për të rishikuar zakonet dhe procedurat e institucionalizuara në mënyrë të

20 Manual mbi: “European non discrimination law, European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Council of Europe, European Court of Human Rights, 2018 edition, faqe 44.

21 KEDNJ (2014) Guidë praktike mbi kriteret e pranueshmërisë (Practical guide on admissibility criteria, ECHR).

22 Biao v. Danimarkë (GC), No.38590/10, 24 Maj 2016, parag. 103; D.H. dhe të tjerë v. the Republika Çeke (GC), No.57325/00, 13 Nëntor 2007, parag.184.

23 Joint reader, supporting the implementation of a course on “Legal protection against discrimination in Southeastern Europe”, editors: Ludwig Boltzmann Institute for Human Rights and South East European Law Schools Network, Authors: Antonija Petričušić, Ivana Grgurev, Oriona Mucollari, Zhaneta Popovska, Andjelija Tasić, Zlatan Meškić, Neda Zdraveva, Mario Vinković. Edition 1, ISBN: 978-3-200-06116-3, December 2018.

përhershme, në mënyrë që t'i bëjnë ata më mikpritës për ndryshim. Kjo është bërë e mundur nga përdorimi i të dhënave statistikore, në mënyrë që të matet “ndikimi i ndryshëm (ose joproporcional)” i masave në dukje neutrale në grupe të caktuara.<sup>24</sup>

Nocioni i diskriminimit indirekt u shfaq ngadalshëm në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Njohja e parë e qartë e nocionit nga ana e Gjykatës ndodhi në rastin e Thlimmenos kundër Greqisë, e vendosur në vitin 2000. Një dëshmitar i Jehovait i ishte mohuar e drejta e regjistrimit si kontabilist i licencuar, për shkak të dosjes së tij penale pas një dënimi pasi kishte refuzuar të kryente shërbimin ushtarak. Gjykata vuri në dukje se autoritetet greke duhet të kishin marrë parasysh se bindja bazohej në sjelljen e motivuar nga besimet fetare të z. Thlimmenos, dhe jo në sjelljen e dyshimeve për moralin e tij ose besueshmërinë, gjë që do të justifikonte arsyetimin përtej rregullave duke përjashtuar nga profesioni i kontabilistëve të akredituar të gjithë personat me dosje penale. Duke arritur në përfundimin se neni 14 i KEDNJ-së ishte shkelur, në përputhje me nenin 9 të KEDNJ-së (liria e fesë), Gjykata vuri në dukje se “e drejta sipas nenit 14 të KEDNJ-së për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara sipas Konventës është shkelur kur Shtetet trajtojnë ndryshe personat në situata të ngjashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm ... Sidoqoftë, e drejta për të mos diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara sipas Konventës, gjithashtu është shkelur kur Shtetet pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dështojnë të trajtojnë ndryshe personat situatat e të cilëve janë dukshëm të ndryshme”.<sup>25</sup>

Ne duhet të kuptojmë se të drejtat e njeriut nuk janë të ngjashme me normat e tjera ligjore /standartet. Ato janë të ndjeshme dhe të lidhura me perceptimin e lartë të lirisë dhe të drejtave në territoret ose vendet specifike. Kjo do të thotë se lufta kundër diskriminimit ose të paktën minimizimi i pasojave, nuk është gjithmonë e thjeshtë dhe nuk ka të dhëna konkrete në lidhje me këtë shkelje. Ndonjëherë nuk ka nevojë të vërtetohet se ka qëllime për paragjykim, nuk ka nevojë të dëshmohet se i përket një grupi të prekshëm, ose ta provojë atë me të dhëna statistikore. Diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mund të ndodhë në të gjitha rrethanat dhe është detyrim i shtetit nëpërmjet mekanizmave të tij të mbrojtës për t'u marrë me situatën deri në eliminimin e plotë të diskriminimit ose të paktën për t'a zvogëluar atë. Është detyrim i Shteteve të ndalojnë dhe t'i japin fund diskriminimit ndaj çdo personi, grupi ose organizatë, me të gjitha mjetet e duhura, duke përfshirë legjisllacionin dhe mekanizmat lehtësues.<sup>26</sup>

24 Oliver De Schutter, *International Human Rights Law, cases, materials, commentary*, Cambridge University Press, pg.626.

25 *Thlimmenos v. Greece (GC)*, No.34369/97, 6 April 2000, §42.

26 Joint reader, supporting the implementation of a course on “Legal protection against discrimination in Southeastern Europe”, editors: Ludwig Boltzmann Institute for

### 1.3 Justifikimi dhe karakteristikat që mbrohen<sup>27</sup>:

Sipas KEDNJ-së, trajtimi i diferencuar, në rastet e pretendimeve direkte dhe indirekte të diskriminimit, i nënshtrohet justifikimit objektiv. Trajtimi i diferencuar mund të justifikohet kur ai ndjek një qëllim legjitim dhe kur mjetet për të ndjekur atë qëllim janë të përshtatshme dhe të nevojshme.

Arsyetimi objektiv përdoret si justifikim për të dyja llojet e diskriminimeve direkt dhe indirekt sipas KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së: “Një dallim në trajtimin e personave në situata të ngjashme ... është diskriminuese nëse nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm; me fjalë të tjera, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet”.<sup>28</sup>

#### **Prandaj, trajtimi i diferencuar i arsyeshëm nuk do të përbëjë diskriminim.**

Jurisprudenca e GJEDNJ tregon se trajtimi i diferencuar në lidhje me çështjet që konsiderohen të jenë në thelb çështje të dinjitetit personal, si diskriminimi i bazuar në racën ose origjinën etnike, jetën private dhe familjare, janë më të vështira për t’u justifikuar sesa ato që lidhen me konsideratat më të gjera të politikës sociale, veçanërisht kur këto kanë ndërlidhje fiskale. GJEDNJ në këtë drejtim përdor terminologjinë e “kufirit të vlerësimit”, i cili i referohet sferës së diskrecionit të shtetit në përcaktimin nëse trajtimi i diferencuar duhet të justifikohet. Kur kjo diferencë konsiderohet “e ngushtë”, GJEDNJ-ja miraton një shkallë më të lartë të shqyrtimit.

Në fakt, siç do të trajtojmë edhe në çështjet më pas, në rastet sensitive, të ndjeshme, si p.sh. rastet e diskriminimit, barazisë gjinore etj., GJEDNJ në interpretimin që i bën KEDNJ, në vendimet e saj, merr përsipër më shumë sesa çështjet e legjislacionit të shteteve përkatëse, analizën e metodave, mekanizmave që shtetet kanë krijuar për të balancuar cënimin apo justifikimin e shkëljes së mundshme të të drejtave të njeriut. Pothuajse në të gjitha çështjet që do të trajtojmë më pas, GJEDNJ ka vënë në diskutim “kufirin e vlerësimit” të shteteve përkatëse gjatë trajtimit të diferencuar.

---

Human Rights and South East European Law Schools Network, Authors: Antonija Petričević, Ivana Grgurev, Oriona Mucollari, Zhaneta Popovska, Andjelija Tasić, Zlatan Meškić, Neda Zdraveva, Mario Vinković. Edition 1, ISBN: 978-3-200-06116-3, December 2018.

27 “Justification and protected grounds” është terminologjia që përdoret në tekstet ndërkombëtare

28 GJEDNJ, *Burden v. the United Kingdom* [GC], No. 13378/05, 29 Prill 2008, paragrafi 60; GJEDNJ, *Guberina v. Croatia*, No. 23682/13, 22 Mars 2016, paragrafi 69.

Për të justifikuar trajtimin e diferencuar, duhet të tregohet:

- ◆ se rregulli ose praktika në fjalë ndjek një qëllim legjitim;
- ◆ se mjetet e zgjedhura për të arritur këtë qëllim (që është masa që ka çuar në trajtimin e diferencuar) është proporcionale dhe e nevojshme për të arritur këtë qëllim.

Për të përcaktuar nëse trajtimi i diferencuar është proporcional, gjykata duhet të bindet se:

- ◆ Nuk ka mjete të tjera për arritjen e këtij qëllimi që imponon më pak ndërhyrje në të drejtën për trajtim të barabartë. E thënë ndryshe, se disavantazhi i vuajtur është niveli minimal i mundshëm i dëmit që nevojitet për të arritur qëllimin e kërkuar;
- ◆ Qëllimi për t'u arritur është mjaft i rëndësishëm për të justifikuar këtë nivel të ndërhyrjes.<sup>29</sup>

Parimi i mosdiskriminimit nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato dallime të bazuara në një nga karakteristikat e mbrojtura.

- ◆ Karakteristikë e mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", nga e cila individët ose grupet dallohen nga njëri-tjetri.
- ◆ Në bazë të direktivave jo-diskriminuese të BE-së, karakteristikat e mbrojtura janë shprehimisht të përcaktuara për: seksin, origjinën racore ose etnike, moshën, aftësinë e kufizuar, besimin ose orientimin seksual.
- ◆ Sipas KEDNJ-së ekziston një listë e hapur, e cila mund të zhvillohet rast pas rasti.

Një "karakteristikë e mbrojtur" është një karakteristikë e një individi që nuk duhet të konsiderohet si e përshtatshme në trajtimin e diferencuar ose gëzimin e një të mire të veçantë.

Sipas KEDNJ-së, neni 14 përmban një listë të hapur, që përputhet me direktivat, por shkon përtej tyre. Neni 14 thekson që nuk do të ketë diskriminim "mbi asnjë bazë, si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, shoqata me një pakicë kombëtare, pronë, lindje apo "status tjetër".<sup>30</sup>

29 Manual mbi: "European non discrimination law, European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Council of Europe, European Court of Human Rights, 2018 edition, faqe 93.

30 Kategoria "status tjetër" ka lejuar GJEDNJ që të përfshijë ato të bazuara (ndër të tjera) që janë të mbrojtura shprehimisht nga direktivat kundër diskriminimit, përkatësisht: aftësia e kufizuar, moshë dhe orientimi seksual.

## LITERATURA E KËSHILLUESHME

Manual mbi: “European non discrimination law, European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, Council of Europe, European Court of Human Rights, 2018 edition.

Oliver De Schutter, International Human Rights Law, cases, materials, commentary, Cambridge University Press.

Rhona K.M.Smith, Libër mbi Të drejtat Ndërkombëtare të Njeriut, Botimi i katërt, Oxford University Press, 2010.

Small, ‘Structure and Substance: Developing a Practical and Effective Prohibition on Discrimination under the European Convention on Human Rights’ (2003) 6 European Journal of Discrimination and the Law 45 at 47; and Baker, ‘The Enjoyment of Rights and Freedoms: A New Conception of the ‘Ambit’ under Article 14 ECHR’ (2006) 69 Modern Law Review 71 faqe 714.

O’Connell, ‘Cinderella Comes to the Ball: “Neni 14 dhe e drejta për mosdiskriminim në Konventë” (2009) 29 Legal Studies 211.

Goodwin, ‘Taking on Racial Segregation: The European Court of Human Rights at a Brown v.

Board of Education Moment?’(2009) Rechtsgeleerd Magazijn.

Wintemute, “Within the Ambit”: How Big is the “Gap” Neni 14 i KEDNJ, 4 *EHRLR* (2004).

Ivana Radacic, Critical Review of Jurisprudence: An Occasional Series *Gender Equality Jurisprudence of the European Court of Human Rights, The European Journal of International Law Vol. 19 no. 4 © EJIL 2008; all rights reserved. EJIL* (2008), Vol. 19 No. 4 , 841 – 857 doi: 10.1093/ejil/chn044.

Komisioni Evropian (2007), "Tackling Multiple Discrimination. Practices, policies and laws".

Joint reader, supporting the implementation of a course on "Legal protection against discrimination in Southeastern Europe", editors: Ludwig Boltzmann Institute for Human Rights and South East European Law Schools Network, Authors: Antonija Petričušić, Ivana Grgurev, Oriona Mucollari, Zhaneta Popovska, Andjelija Tasić, Zlatan Meškić, Neda Zdraveva, Mario Vinković. Edition 1, ISBN: 978-3-200-06116-3, December 2018.

KEDNJ (2014) Guidë praktike mbi kriteret e pranueshmërisë (Practical guide on admissibility criteria, ECHR).



## KREU II

# Diskriminimi mbi bazë gjinie dhe dhuna gjinore. Nocione dhe jurisprudenca e gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut<sup>31</sup>

---

### 2.1 Nocioni i barazisë gjinore dhe diskriminimit me bazë gjinie

Në këtë pjesë do të sjellim disa vendime të ndryshme të GJEDNJ në lidhje me diskriminimin gjinor. Si përmendëm dhe më sipër GJEDNJ është përpjekur më së shumti të analizojë metodat dhe “kufirin e vlerësimit”, që shtetet përdorin për të analizuar nëse kemi të bëjmë me një rast diskriminues. Në këtë prezantim të shkurtër, të përmbledhur, të disa prej çështjeve të shqyrtuara nga GJEDNJ, do të kuptojmë faktin sesa të vështirë e ka pasur dhe GJEDNJ të artikulojë një vendim duke gjetur diskriminim gjinor e gjithashtu duke drejtuar shtetet në përmirësimin e mbrojtjes ligjore kombëtare, sidomos në situatën e dhunës në familje por edhe në situata të tjera diskriminuese gjinore në fusha si punë, arsim etj. Ajo që bie më shumë në sy në këtë prezantim vendimesh gjyqësore të GJEDNJ në lidhje me diskriminim gjinor është ndryshimi i përmbajtjes së vendimeve gjyqësore vitet e fundit. GJEDNJ artikulon më fuqishëm dhe hapur rastet e dhunës në familje duke paraprirë shtetet në rregullimin e akteve të tyre ligjore kombëtare në fushën e barazisë gjinore dhe në veçanti dhunës në familje.

---

31 Factsheet – Gender equality, ECHR, Press Unit, January 2019.

Parimi i “barazisë gjinore” është një nga parimet themelore të korpusit normativ të të drejtave të njeriut. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se “ *barazia midis sekseve është një nga qëllimet kryesore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës*<sup>32</sup>”, por gjithashtu edhe “*një nga parimet bazë mbi të cilën ngrihet Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut*” (KEDNJ).<sup>33</sup> Si një parim kyç që ndihmon në zhvillimin e çdo shoqërie demokratike, njohja dhe aplikimi i drejtëi tij nga studentët e drejtësisë, por edhe më gjerë, nga praktikuesit e të drejtës në Shqipëri merr një rëndësi mjaft të madhe. Në këtë pjesë të manualit do t’i kushtojmë vëmendje trajtimit konceptual dhe jurisprudencial të parimit të barazisë gjinore me fokus të veçantë tek dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje si derivate të marrëdhënieve historikisht të pabarabarta midis burrave dhe grave në shoqëri.

Diskriminimi për shkak të gjinisë shkel parimin e barazisë së të drejtave dhe dinjitetin njerëzor duke u shndërruar në një pengesë për pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në të gjitha sferat e jetës ekonomike, politike, sociale apo kulturore.<sup>34</sup> Në këtë kuptim barazia gjinore duhet të kuptohet si një parakusht për realizimin e të gjitha të drejtave të tjera në shoqëri. Nisur nga sa më sipër, parimi i barazisë gjinore duhet të kuptohet si një parim që ka si qëllim pjesëmarrjen e plotë të burrave dhe grave dhe përfitimin njëjloj të tyre në shoqëri dhe që mund të arrihet përmes garantimit të a) shanceve dhe mundësive të barabarta b) pjesëmarrjes së barabartë c) pozitës së barabartë të burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës në shoqëri.<sup>35</sup>

Garantimi i parimit të barazisë gjinore në këtë drejtim është shumë më gjerë se sa vetëm barazia “*de jure*” apo “*përpara ligjit*” e burrave dhe grave në shoqëri. Ky parim përbëhet nga disa komponentë dhe duhet të kuptohet se përfshin a) barazinë në ushtrimin e të drejtave b) aksesin e barabartë në të gjitha sferat e jetës shoqërore c) barazinë në trajtim d) barazinë në shance dhe mundësi si edhe d) barazinë në përfitime nga të gjitha arrijtet e jetës shoqërore. Shtrirja më e gjerë e parimit të barazisë

32 Shih GJEDNJ (1985) “ Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, Seria A, Nr 94, paragrafi 78 cituar nga Radacic.I (2008) Gender Equality Jurisprudence of the European Court of Human Rights tek *The European Journal of International Law*, Vol.19, nr 4 fq 841-2; GJEDNJ (2012) Kostandintin Markin kundër Ruisisë, Vendim i Dhomës së Madhe, paragr 127.

33 Shih GJEDNJ (2005) Vendim i Dhomës së Madhe “Leyla Sahin kundër Turqisë”, Përmbledhje 2005, paragr.115 cituar nga Radacic.I (2008) ibid, fq 842.

34 Shih Preambulën e CEDAW ( Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave), ratifikuar nga shteti Shqiptar më 23.06.2003 tek <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm>

35 Ligj Nr 9970 datw 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në Shoqëri”, Neni 4.

përtej aspektit të pastër normativështë pranuar edhe nga Organizata Ndërkombëtare të Punës (ONP) e cila nënvizon se *“Barazia gjinore nënkupton jo vetëm që gratë dhe burrat kanë kushte të njëjta për të realizuar të drejtat e tyre njerëzore, por gjithashtu, përfitojnë njëllot nga zhvillimet ekonomike, sociale , kulturore dhe politike.”*<sup>36</sup> Kjo na bën që kur të trajtojmë parimin e barazisë gjinore të nënkuptojmë atë të njëjtën kohë si a) barazinë në dhe përpara ligjit të burrave dhe grave në shoqëri ashtu edhe b) barazinë rezultative apo barazinë ‘de facto’ të burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Realizimi i barazisë “de jure” dhe “de facto” midis burrave dhe grave është një element kyç për të parandaluar dhunën ndaj grave. Për këtë arsye është e rëndësishme fillimisht të njihemi me mënyrën se si i ka trajtuar GJEDNJ këto dy koncepte të barazisë dhe më pas të ndalemi në analizën e saj në lidhje me nocionin e dhunës në vetvete.

Kështu, nocioni i barazisë “de jure” dhe “de facto” është elaboruar gjerësisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Për shumë vite, GJEDNJ e shihte diskriminimin për shkak të gjinisë vetëm përmes një lenteje të barazisë formale. Përkufizimi i një qasjeje të tillë, nganjëherë i quajtur barazi de jure, është që personat që vendosen në situata të ngjashme duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe se nuk mund të bëhen dallime mbi bazën e karakteristikave të veçanta të mbrojtura ( si gjinia) pa një justifikim legjitim dhe të arsyeshëm. Shkurtime: gratë kanë të njëjtat të drejta si burrat<sup>37</sup>.

36 Shih ABC of Women Workers’s Rights and Gender Equality. ILO (2000), Geneva tek [http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---gender/documents/publication/wcms\\_087314.pdf](http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---gender/documents/publication/wcms_087314.pdf) cituar nga OSCE (2015) “Manual for Gender Equality at local level” fq 5 tek <https://www.osce.org/bih/216636>.

37 Timmer.A (2011) Toward a Anti-Stereotyping Approach for the European Court of Human Rights tek *Human Rights Law Review* 11(4), Oxford University Press, fq 710.

**Abdulaiz, Cabaes dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar** (Abdulaiz, Cabaes dhe Balkandali Vs Mbretëria e Bashkuar, 1985)

Kërkueset ishin vendosur ligjrisht dhe në mënyrë permanente në Mbretërinë e Bashkuar. Në përputhje me rregullat e emigracionit në fuqi, bashkëshortëve të tyre iu refuzua leja për të qëndruar me/ ose bashkuar me kërkueset në MB si bashkëshortë. Ndërkohë që një e drejtë e tillë garantohej vetëm për emigrantët meshkuj që mund të ishin në të njëjtën situatë. Kërkueset pretendonin përpara gjykatës se për këtë qëllim ata kishin qenë viktimë të diskriminimit për shkak të gjinisë dhe racës.

Trajtimi i diferencuar: Legjislacioni i MB në lidhje me rregullat e emigrimit në atë kohë bënte një dallim midis emigranteve femra dhe meshkuj: gratë, partnerët e të cilëve ishin ligjrisht rezident në MB, lejohehin të bashkoheshin me parterët e tyre, ndërkohë që e kundërta nuk lejohej.

MB prapësoi në gjykatë se ky rregull ishte vendosur për të mbrojtur tregun e punës : burrat mund të kishin një ndikim më pozitiv në tregun e punës sësa gratë. Gjykata, megjithëse pranon argumentin e Qeverisë në lidhje me qëllimin e rregullit të vitit 1980, argumenton se ky qëllim nuk legjitimon ndryshimin në trajtim midis femrave dhe meshkujve emigrant në lidhje me lejimin e bashkëshortëve të tyre të huaj për të hyrë ose për të qëndruar në MB .Gjykata vendosi se kërkueset ishin viktimë të diskriminimit për shkak të gjinisë në shkelje të nenit 14 të KEDNJ.

***Përfundim: Në këtëçështje Gjykata elaboron konceptin e barazisë “de jure” midis burrave dhe grave në kuptimin që të dyja gjinive duhet t’iu garantohen të drejta të njëjta në ligj dhe të jenë të barabartë përpara ligjit. Sipas GJEDNJ Shtetet duhet të japin arsye shumë të forta (objektive dhe legjitime) për të justifikuar që një diferencë në trajtim i bazuar në gjini të mos jëtë në shkelje të NENIT 14 të KEDNJ. ( Paragr 78)***

Interpretimi stikt i gjykatës në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë vihet re edhe në rastet kur gjykata nuk pranon justifikimet e autoriteteve publike për miratimin e rregullave të bazuara në stereotipa ose karakteristika të lidhura vetëm me seksin e personit duke i cilësuar ato jo si arsye shumë të forta . Shembull i standartit të lartë të gjykatës në lidhje me justifikimin është vendimi i GJEDNJ në 2014 nëçështjen Emel Boyraz Kundër Turqisë.

Ndërkohë, që duke analizuar konceptin e barazisë formale apo “de jure” si standartin më minimal të barazisë midis burrave dhe grave, GJEDNJ në vazhdim

të jurisprudencës së saj thekson rendësinë e barazisë faktike (në praktikë) midis të dyja gjinive. Për të arritur në këtë nocion, Gjykata ndalet në analizën tashmë jo vetëm të kuadrit normativ në fuqi në një vend, por edhe të disavantazheve që mund t'i vijnë njëres prej gjinive nga zbatimi në praktikë kuadrit normativ apo rregullave në fuqi. Në jetën reale, rregullat neutrale mund të jenë diskriminuese<sup>38</sup>. Për më tepër, në një shoqëri të karakterizuar nga ndarja e pabarabartë e fuqive/pushtetit midis burrave dhe grave, barazia formale nuk mund ta zgjidhë problemin e diskriminimit, në një kohë kur efekti i trajtimit të barabartë bazohet në ndryshimin në gjendjen faktike të tyre, gjendje e cila nuk është e përfshirë në vetë normën

juridike.<sup>39</sup> Pikërisht në këtë drejtim GJEDNJ elaboron konceptin e barazisë “de facto” duke e lidhur pikërisht me nocionin e diskriminimit indirekt. Qasja e barazisë faktike bazohet pikërisht në analizën nëse zbatimi i ligjit/rregullave ka efekt diskriminues dhe jo në faktin nëse ligji në vetvete përmban një dallim të shprehur për gratë ose burrat. (Pa) barazia faktike fokusohet më tepër në (pa)barazinë e rezultateve sesa në trajtimin e (pa)barabartë.<sup>40</sup> Sipas GJEDNJ “ ***një politikë ose masë e përgjithshme që ka efekt paragjyqës disproporcionale mbi një grup ( femrat ose meshkujt psh) mund të konsiderohet diskriminuese edhe nëse kjo masë nuk është e drejtuar direkt kundrejt atij grupi dhe nëse nuk ekziston qëllimi diskriminues.***<sup>41</sup> Siç e shohim, dy elementët më të rëndësishëm për të evidentuar pabarazinë në fakt për shkak të gjinisë lidhen me:

- a) efekti në praktikë që ka një normë/ligj/rregull që edhe pse i krijuar në terma neutrale sjell efekte negative më shumë për gratë sesa burrat ose e kundërta;
- b) fakti që diskriminimi indirekt nuk kërkon domosdoshmërisht qëllimin diskriminues.

38 Fredman, *Discrimination Law*, botim I 2-të (Oxford/New York: Oxford University Press, 2011) tek 177-89 cituar nga Timmer.A (2011) *Toward a Anti-Stereotyping Approach for the European Court of Human Rights* tek *Human Rights Law Review* 11(4), Oxford University Press, fq 712.

39 Jenny E. Goldschmidt (2017) *New Perspectives on Equality: Towards Transformative Justice through the Disability Convention?*, *Nordic Journal of Human Rights*, 35:1, 1-14, DOI: 10.1080/18918131.2017.1286131

40 Fredman.S (2016) “Emergin from the Shadows: Substantive Equality and Article 14 of the Convention on Human Rights” tek *Human Rights Law Review*, 1-29.

41 ECtHR, *Biao v. Denmark* [GC], No. 38590/10, 24 May 2016, paragr 93.

Emel Boyraz kundër Turqisë (2014):

Kërkueses iu mohua pozicioni si oficer sigurie në kompaninë shtetërore të elektricitetit sepse ajo ishte grua. Megjithëse Zj.Emel kishte kaluar në mënyrë të sukseshme provimin e shërbimit publik, ajo u informua nga autoritet publike se nuk mund ta fitonte vendin e punës pasi nuk plotësonte kriterin e të qenit burrë. Shteti justifikojë se ky dallim mbi bazë gjinie ishte bërë duke pasur parasysh faktin se kjo punë i kërkonte të punësuarit të mbante armë, të punonte natën dhe ditën dhe të përdorte forcën fizike në rast sulmi, për të cilën gratë nuk ishin të përshtatshme.

GJEDNJ nënvizon se “ avancimi i barazisë gjinore është një qëllim kryesor në Shtetet Anëtare dhe për këtë arsye shteti duhet të tregojë arsye shumë të forta në mënyrë që një trajtim i diferencuar të shihet në pajtim me KEDNJ.(paragr 51). Në rastin në fjalë sipas Gjykatës nuk ishte dhënë asnjë shpjegim se pse gratë ishin të pamundura për ta kryer këtë punë.

***Përfundim: Fakti i vetëm se oficerët e sigurisë duhet të kryejnë turne natë dhe në zona rurale dhe që mund t’iu kërkohej të përdorin forcën fizike dhe të mbajnë armë në rrethana të caktuara nuk mundet në vetvetë të justifikojë trajtimin e diferencuar midis burrave dhe grave. Për këtë arsye kriteri i vendosur nga shteti turk conte në diskriminim për shkak të gjinisë. (paragr 54)***

Biao vs.Danimarka ( GJEDNJ, Dhoma e Madhe, vendim i 24 Maj 2016)

Kërkuesi, Z.Biao, ishte shtetas danez me origjinë nga Gana i lindur në 1971, kishte jetuar në Danimarkë që nga 1993 dhe kishte marrë shtetësinë danëze në 2002. Në 2004 ai donte të vendosej në Danimarkë me gruan e dytë me shtetësi nga Gana të cilën ai e kishte takuar dhe ishte takuar gjatë një vizite në Ganë. Cifti kishte një fëmijë që kishte fituar shtetësinë danëze për shkak të shtetësisë së babait. Kërkesa e Zj.Biao për të bërë bashkimin familjar në Danimarkë u refuzua. Në të njëjtën kohë edhe ankimi që Zj.Biao i bëri refuzimit të autoriteteve kombëtare u refuzua nga Gjykata e Lartë. Kërkuesi kërkonte pretendonte përpara Gjykatës se ishte diskriminuar në mënyrë indirekte në lidhje me aplikimin e tij për të përfituar bashkimin familjar duke shkelur Nenin 14 në lidhje me Nenin 8 të KEDNJ.

Sipas ligjit danez mbi bashkimin familjar, leja e qëndrimit garantohej vetëm nëse cifti plotëson kërkesën e lidhjes së qëndrueshme me vendin, që nënkupton se lidhjet e ciftit me Danimarkën janë më të forta se sa më cdo vend tjetër. Po kështu në 2003, në lidhje

me këtë çështje, hyri në fuqi ligji i "28 viteve". Sipas këtij ligji kërkesa e mësipërme nuk kërkohej nëse një bashkëshort kishte qënë shtetas danez për të paktën 28 vjet ose në rast se nuk kishte shtetësinë daneze, të kishte lindur dhe/ose rritur në Danimarkë dhe të kishte qëndruar aty në mënyrë të ligjshme për 28 vjet. Në rastin e çiftit Biao asnjë nga të dyja kërkesat nuk plotësoheshin: rregulli i 28-viteve nuk gjente zbatim dhe ata nuk plotësonin as kriterin e lidhjes sëfortë duke qënë se Zj.Biao nuk kishte qënë kurrë në Danimarkë përpara martesës, nuk fliste danisht dhe çifti ishte takuar në Gana. Pavarësisht vendimit të Dhomës se ndërhyrja në jetën private dhe familjare në këtë rast ishte e justifikuar, Dhoma e Madhe, duke analizuar ndikimin që mund të kishte rregulli i 28 viteve në grupe të ndryshme vendosi se ky rregull vendos në disavantazh ose ka një efekt paragjykses disproporcional mbi personat që e kanë fituar shtetësinë daneze më vonë në jetë dhe që ishin me origjinë etnike të ndryshme nga ajo daneze.(paragr 138) Trajtimi indirekti diferencuar midis shtetazve danezë dhe jo danezë nuk ishte i justifikuar, nisur nga fakti se marzhi i vlerësimit të shteteve në çështjet e diskriminimit duhet të jetë shumë i ngushtë.( paragr 138)

***Përfundim: Trajtimi i diferencuar mund të marrë formën e një efekti paragjykses joproporcional të një mase të përgjithshme, e cila edhe pse e krijuar në terma neutral, diskriminon një grup mbi bazën e karakteristikave të mbrojtura. Diskriminimi indirekt nuk kërkon domosdoshmërisht verifikimin e qëllimit diskriminues. Fokusi kryesor është efekti diskriminues që sjell norma , pavarësisht qëllimit të krijimit të saj.***

I njëjti qëndrim është mbajtur edhe tek D.H dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, 2007, paragr.184.

Me interes në kuadër të barazisë substantive është edhe vendimi i gjykatës në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë, në të cilin, GJEDNJ analizon se e drejta për të mos u diskriminuar nënkuton jo vetëm detyrimin për të trajtuar personat njëllor në situata analoge, por edhe detyrimin për të marrë në konsideratë edhe situatat e ndryshme në të cilat ata ndodhen. *Pra shtetet mund të detyrohen të mbajnë përgjegjësi në bazë të nenit 14 të Konventës edhe në rast se nuk i trajtojnë personat në përputhje me situatën ata ndodhen.* Për ta kuptuar më qartë, një shtet mund të mbajë përgjegjësi nëse, në mungesë të një qëllimi legjitim dhe arsyeje objektive, trajton njëllor personat që ndodhen në situatë jo analoge.

**Çështja Thlimmenos kundër Greqisë:**Kërkesa Nr 34369/97, 6 Prill 2000. Në këtë rast kërkuesi nuk u lejua të regjistrohej si një kontabilist sepse kishte një dosje penale. Dënimi i tij penal u imponua për shkak se ai refuzoi shërbimin e detyrueshëm ushtarak, të cilin ai e bëri në bazë të bindjes së tij fetare (Dëshmitari i Jehovahit).Si rezultat, bindja e tij fetare e pengonte atë të bëhej kontabilist. Kërkuesi argumentonte përpara gjykatës së shtatë e tij ishte e ndryshme nga ajo e personave që kishin dosje penale për kryerjen e një krimi serioz dhe të rëndë siç e parashikonte ligji. Në këtë kontekst ai pretendonte se ishte diskriminuar për shkak se shteti nuk e kishte trajtuar në mënyrë të diferencuar nisur nga situata e ndryshme që ai kishte në krahasim me të dënuarit e tjerë. ***Në gjykimin e saj Gjykata konstatoi se e drejta për të mos diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara sipas Konventës shkelet gjithashtu kur shtetet pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dështojnë të trajtojnë ndryshe personat, situata e të cilëve, është dukshëm e ndryshme.***(paragr 42-44)

## 2.2 Koncepti i dhunës me bazë gjinore dhe dhuna në familje.

Gratë në të gjithë botën, pavarësisht statusit, moshës, besimit fetar mund të jenë subjekte të dhunës në të gjitha sferat e jetës kudo ku atomund të ndodhen: në shtëpi, në punë, në rrugë, në institucione qeveritare ose në kohë konfliktesh apo krizash. Dhuna gjithashtu është prezente gjatë gjithë ciklit të jetës të grave duke prekur si vajzat e reja ashtu edhe gratë e moshuara.<sup>42</sup>**Në aspektin konceptual, nocioni më i saktë i Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje** është ai i elaboruar në Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje ( Konventa e Stambollit). Në këtë Konventë dhuna ndaj grave (DHG) kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet **e dhunës gjinore** që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose **vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike** për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private.<sup>43</sup>

Ndërkohë që Dhuna në Familje duhet të kuptohet po në lidhje me këtë konventë si **tërësia e akteve të dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike** që

42 United Nation Human Rights ( 2014) Women's Rights are Human Rights, New York and Geneva, fq 75.

43 Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Neni 3.



ndodhin brenda familjes ose nësisë shtëpiake<sup>44</sup>. Nocioni i “anëtarëve të familjes” është elaboruar nga GJEDNJ duke mos përfshirë vetëm bashkëshortët, por edhe më gjerë. DHF ndodh ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, ndërmjet prindërve dhe fëmijëve dhe të gjithë anëtarëve të tjerë në familje që gëzojnë statusin e personit në lidhje gjaku/ familjare. Edhe pse termi “në familje” mund të duket se kufizohet në aktet që ndodhin brenda shtëpisë, DHF mund të ndodhë edhe midis partnerëve apo atëtarëve të familjes që nuk jetojnë bashkë. Pra, që të jemi përpara DHF, kusht nuk është vendi se ku kryhet akti i dhunës, por marrëdhënia midis viktimës dhe dhunuesit dhe veprimet që mund të kategorizohen si akte dhune.

*“Çështja e dhunës në familje, e cila mund të marrë formë të ndryshme nga dhuna fizike tek psikologjike ose abuzim verbal...është një problem i përgjithshëm që shqetëson të gjitha Shtetet Anëtare dhe që jo gjithmonë është e dukshme nisur nga fakti që DHF shpesh ngelet brenda marrëdhënieve personale ose qëndron në një rreth të mbyllur dhe nuk janë vetëm gratë që preken nga jo. GJEDNJ njih që burrat gjithashtu mund të jenë viktimë të DHF dhe gjithashtu fëmijët janë të prekur në shumë raste si në mënyrë direkte ashtu edhe indirekte...”* (GJEDNJ, Opuz kundër Turqia, vendim i 9 qershor 2009, paragr 132)

ECTHR: Factsheet –Domestic Violence, Janar 2018

Si formë e dhunimit të dinjitetit njerëzor dhe në formën më të rëndë të saj si shkelje e të drejtës së jetës, DHG përbën një shprehje ekstreme të **pabarazisë mbi bazë seksin**, që shprehet në **diskriminim në bazë të gjinisë**.Konventa e Stambollit njih se DHG është rezultat i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta midis burrave dhe grave.

Dhuna kundër grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe kanë penguar përparimin e të plotë të grave... dhuna kundër grave është një prej mekanizmave thelbësorë socialë me të cilin gratë janë të detyruara të vendosen në një pozicion varësie në krahasim me burrat. (Konventa e Stambollit, Preambula)

## 2.3 Jurisprudenca e GJEDNJ mbi dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje:

Jurisprudenca e GJEDNJ ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin dhe fuqizimin e kuadrit ndërkombëtar të Dhunës ndaj Grave. Në interpretim që Gjykata i bën nocionit të Dhunës ajo bazohet në të drejtat e garantuara në Konventë. Në fakt, na duhet të kujtojmë se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk ka një parashikim specifik që ndalon dhunën ndaj grave/në familje. Ligjvënësi evropian nuk i ka kushtuar një Nen të veçantë mbrojtjes ndaj “dhunës në familje”. Megjithatë DHG është cilësuar nga GJEDNJ si shkelje e “të drejtave të njeriut” dhe shfaqje ‘diskriminimi’. Për këtë arsye duhet të shihet lidhja e saj me të drejtat e tjera të KEDNJ.

Nisur nga fokusi i KEDNJ në lidhje me të drejtat civile dhe politike, detyrimet e shteteve kundër DHG dhe DHF lidhen kryesisht me:

- ◆ Të drejtën e Jetës ( Neni 2)
- ◆ Ndalimin e Torturës ( Neni 3)
- ◆ E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (Neni 8)
- ◆ Ndalimi i Diskriminimit ( Neni 14)

### 2.3.1 Nga Privatësia tek detyrimi pozitiv i shteteve në rastet e Dhunës në familje

Diktonomia Publik/ Privat ka qënë një faktor që ka vonuar në përcaktimin e DHG si shkelje e të Drejtave të Njeriut. Dhuna në familje për një kohë relativisht të gjatë njihet dhe konsiderohej si njëçështje e jetës private duke pamundësuar në këtë mënyrë ndërhyrjen e autoriteteve publike në rast të verifikimit të saj. Po kështu , në periudhat më të hershme, ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dukej se ishin krijuar me qëllim që të vendosnin detyrime vetëm ndaj shteteve. Si rrjedhim çështje ndërpersonale si DHG nuk ishin brendaqëllimit dhe frymës së ligjeve ndërkombëtare. Kjo qasje bënte që DHG që ndodhte brenda ambienteve të shtëpisë të konsiderohej për vite si çështje private brenda konceptit të Nenit 8 të KEDNJ duke bërë një ndarje midis viktimave të dhunës nga subjektet shtetërore dhe viktimat e dhunës nga subjektet private ( bashkëshort, bashkëjetues, anëtar familje etj). Në këtë kontekst ndërkohë që Gjykata merre në shqyrtim rastet në të cilën gratë kishin qënë viktimat të dhunës shtetërore, analiza e saj rrallë lidhet me adresimin e dhunës midis individëve privatë me njëri tjetrin<sup>45</sup>. Lidhja e nocionit të “dhunës” me Nenin 8 të KEDNJ bazohet

45 Abdel-Monem, Tarik. “Opuz v. Turkey: Europe’s Landmark Judgment on Violence Against Women.” Human Rights Brief 17, no. 1 (2009): 30.

në faktin se dhuna konsiderohet si cënim i integritetit fizik, moral, psikologjik që mbulohen nga koncepti i jetës private<sup>46</sup>.Për këtë arsye një nga konkluzionet më të rëndësishme të GJEDNJ në lidhje me detyrimet e shteteve në rastet e dhunës në familje është vendimi i Gjykatës nëçështjen Bevacqua dhe S.v K Bullgarisë ku ajo nënvizon se “ *Ta konsiderosh DHF si një çështje private është e papajtueshme me detyrimet e autoriteteve në kuadër të Nenit 8 të KEDNJ*<sup>47</sup>”. Në këtë këndvështrim, edhe pse objekti kryesor i Nenit 8 është mbrojtja e individëve nga veprimet arbitrare të autoriteteve publike, këto detyrime mund të përfshijnë marrjen e masave në sferën e marrëdhënieve të individëve me njëri-tjetrin. Shtetet kanë përgjegjësi për të ndërhyrë në rastet e DHF ose abuzimeve brenda sferës private. Për sa më sipër GJEDNJ vendos për here të pare tek Airey kundër Irlandës se “*Edhe pse Neni 8 përgjithësisht mbron jetën private nga ndërhyrjen e padrejta të shtetit, ai, mund , në disa raste, të veprojë në drejtimin e kundërt dhe të detyrojë qeveritë të marrë masa pozitive për të lejuar individët të gëzojnë respektin për jetën e tyre private*<sup>48</sup>”

Bevacqua dhe S kundër Bullgarisë (Kërkesa nr 71127/01, 12 Qershor 2008)

Kërkuesja ishte sulmuar në katër raste të veçanta nga bashkëshorti i saj gjatë procedurave të divorcit dhe kujdestarisë.Dështimi i Shteti për të marrë masa mbrojtëse me argumentimin se mosmarrëveshja ishte një çështje me karakter privat çoi i kufizimin e kërkueses për të marrë ndihmën e nevojshme. GJEDNJ nënvizoi ekzistencën e detyrimit të shtetit për të parandaluar, hetuar dhe ndëshkuar aktet e dhunës kundër grave, *pavarësisht faktit nëse ato ishin kryer nga individë privatë apo shtetërorë.* (paragr 65) sipas GJEDNJ “*edhe pse objekti kryesor i Nenit 8 është mbrojtja e individëve nga veprimet arbitrare të autoriteteve publike, këto detyrime mund të përfshijnë marrjen e masave në sferën e marrëdhënieve të individëve me njëri-tjetrin.*” (paragr 64).

46 GJEDNJ, A kundër Kroacisë, Kërkesa nr 55164/08 datë 14.10.2010 paragr 58-60 cituar nga Jakstiene.R (2014) Domestic Violence in case – law of European Court of Human Rights tek Moksliniu straipsiu rinkinys, Artikuj Shkencr 2014(11), fq 71

47 GJEDNJ, Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë, Kërkesa nr 71127/01 datë 12.06.2008, paragr 83 cituar nga Jakstiene.R (2014) Domestic Violence in case – law of European Court of Human Rights tek Moksliniu straipsiu rinkinys, Artikuj Shkencor 2014(11), fq 69-70.

48 GJEDNJ, Airey kundër Irlandës, kërkesa nr 6289/73 datë 9 tetor 1979, paragr 32.

A kundër Kroacisë ( Kërkesa nr.55164/08 datë 14 Tetor 2010

Çështja lidhej me Zj.A e cila për një periudhë prej më shumë se 7 vitesh kishte përjetuar dhunë verbale (përfshirë kërcënimet për vdekje) dhe dhunë fizike ( përfshirë goditje në kokë,fytyrë, trup etj) nga ish bashkëshorti i saj i cili vuante nga çrregullime të lehta mendore. Atij i ishte rekomanduar trajtim i detyrueshëm psikiatrik.Ish bashkëshorti shpesh abuzonte me kërkuesen në prani të vajzës së mitur dhe në disa raste ndërmerte veprime të dhunshme edhe ndaj kësaj të fundit.Pas një periudhe të gjatë mosraportimi, kërkuesja i kërkoi gjykatës lëshimin e një urdhëri mbrojtjeje ndaj ish-bashkëshortit të saj.Gjykatat kombëtare e refuzuan kërkesën me argumentimin se kërkuesja nuk kishte treguar një rrezik imediat për jetën e saj.

Gjykata vendosi Shkelje të Nenit 8 të KEDNJ duke nënvizuar se **“ dhuna e përjetuar nga kërkuesja shtrihej brenda sferës së të drejtës për jetë private ( neni 8 KEDNJ) nisur nga fakti se çështja lidhej me mbrojtjen e integritetit psik, moral dhe psikologjik të kërkuese që mbulohej nga Neni 8 i Konventës.Në përputhje me Nenin 8 Shtetet kanë një detyrim pozitiv për të marrë masat e duhurapër të haartuar ose zbatuar në praktikë një kuadër ligjor adekuat që mbështet mbrojtjen kundër akteve të dhunës të kryera nga individët privatë.** (paragr 58-60)

Në vazhdim të interpretimeve të saj mbi DHG dhe DHF GJEDNJ ka elaboruar edhe doktrinën e kudesit të duhur (due diligence) sipas të cilës, shtetet mund të jenë përgjegjëse për veprimet e kryera nga persona privatenëse atë dështojnë për të vepruar me kujdesin e duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe ndëshkuar veprimet e dhunës si edhe për të garantuar dëmshpërblimin. (Rek.19 CEDAW)

Kjo qasje nënkupton përgjegjësinë e shtetit jo për veprimet direkte të tij, por edhe për shkak të mungesës së kujdesit të duhur për të parandaluar dhunën nga veprimet e personave privatë<sup>49</sup>. GJEDNJ ka theksuar në disa raste se vetëm ekzistenca e kuadrit ligjor nuk është e mjaftueshme për të mbrojtur viktimat nga dhuna në familje. Shteti duhet në rastet qëështë në dijeni të ekzistencës së rrezikut real dhe serioz për viktimat e dhunës në familje të marrë të gjitha masat e nevojshme, me kujdesin e duhur, për të parandaluar ardhjen e pasojave të dëmshme për viktimën e dhunës. Megjithatë në rastin kur dhuna shkaktohet midis individëve privateme njëri tjetrin, shteti, në mënyrë që të ngarkohet me përgjegjësi duhet të kaolë testin e vendosur

49 Shih Rekomandim Rec(2002) 5 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi mbrojtjen e grave nga dhuna, Sesion 794, 30 Prill 2002.

nga GJEDNJ nëçështjen Osman kundër Turqisë. I njohur si testi 3 pjesësh, ai mund të vendosë një shtet nën përgjegjësinë për shkak të mos garantimit të të drejtave të parashikuara në Konventë nëse plotësohen këto kushte: a) shteti ka dijeni ose nga tërësia e rrethanave dhe fakteve kaqëni detyruar të ketë pasur dijeni; b) duhet të ekzistojë një rrezik real dhe i menjëhershëm për viktimën dhe c) autoritetet publike të mos kenë vepruar ose të mos kenë marrë masat e duhura për të shmangur rrezikun<sup>50</sup>. Kjo doktrinë detyron shtetin për të marrë masa mbrojtëse paraprake dhe/ose për të hetuar dhe ndëshkuar me përgjegjshmëri të gjitha rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

### 2.4 Jurisprudenca e GJEDNJ për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Njohja se Dhuna Ndaj Grave është Dhunë me Bazë Gjininë është pranuar nga GJEDNJ fillimisht nëçështjen Opuz kundër Turqisë.<sup>51</sup> Edhe pse gjykata pranon se jo çdo rast i DHG është me bazë gjinore, DHF prek kryesisht gratë. Në këtëçështje GJEDNJ ka vendosur se dështimi i autoriteteve për të mbrojtur efektivisht dhunën në familje, shkel Nenin 14 edhe pse në mënyrë të paqëllimtë. Turqia në këtë rast ishte përpara një pasiviteti juridik të përgjithshëm dhe psetë paqëllimshëm, i cili rezultoi në humbjen e jetës së nënës së kërkueses për shkak të vrasjes nga ish-bashkëshorti dhunues i kërkueses. Në rastin në fjalë gjykata pranon nocionin e diskriminimit indirekt duke qënë se praktika e ndjekur nga autoritet në dukje ishte neutrale. I njëjti qëndrim mbahet nga GJEDNJ edhe tek Mundric Kundër Moldavisë në të cilën Gjykata vendos që jemi në shkelje të nenit 14 në lidhje me Nenin 3 në lidhje me faktin se autoritetet kishin toleruar sulmet fizike dhe psikologjike në shtëpi nga ish-bashkëshorti dhe kishin dështuar për të vënë në zbatim urdhërat e mbrojtjes. Edhe në këtë rast, duke qënë se praktika në dukje ishte neutrale GJEDNJ u bazua në raporte të raporterit special të OKB mbi situatën e grave në Moldavi mbi të cilat u ngrit çështja e diskriminimit: autoritetet në mënyrë të përsëritur nuk hetonin DHG dhe ky qëndrim ishte diskriminues sipas GJEDNJ. Në secilin prej rasteve të analizuara, vendimet e GJEDNJ mbi Nenin 14 janë të bazuar në prova *prima facie* të sjella nga kërkuesi dhe të mbështetura nga të dhëna statistikore, raporte të organeve ndërkombëtare, praktikës së mëparshme gjyqësore etj.

Në raste të tjera GJEDNJ e ka lidhur nocionin e Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj grave me Nenin 2 dhe 3 të KEDNJ. Pikërisht në rast se si rezultat i akteve të dhunshme vijnë pasoja që lidhen me cënimin e të drejtës për jetë të viktimës atëherëçështja do

50 GJEDNJ: Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1998-VIII, EUR, HR, 3124 paragraf 116.

51 GJEDNJ Opuz kundër Turqisë, 9 qershor 2009

të ngrihet në bazë të nenit 2; ndërkohë që në rast se si pasojë e akteve të dhunshme kërkuesit i janë shkaktuar dëme që prekin integritetin fizik ose psikologjik të tij, por pa shkuar deri tek humbja e jetës, atëherëçështja e DHF ngre aplikueshmërinë e Nenit 3 të KEDNJ. Në të dyja rastet shtetet mund të mbajnë përgjegjësi si përsa i përket shkeljes së të drejtës në kuptimin material, ashtu edhe në lidhje me cënimin procedural, që në këtë rast do të lidhej me dështimin e autoriteteve për të hetuar në lidhje me humbjen e jetës osë ushtrimin e torturës.

Pikërisht për t'u njohur në mënyrë më të plotë me risitë e jurisprudencës së GJEDNJ në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjininë, në materialin më poshtë do të keni mundësi të njiheni me disa nga rastet më të rëndësishme të shqyrtuara nga kjo gjykatë në këtë fushë.<sup>52</sup>

### ■ **Branko Tomasic Vs Kroaci (15 janar 2009): Neni 2**

Pas kërcënimeve të vazhdueshme për jetën, agresori që vuante nga çrregullime të personaliteti mendor u dënua dhe mori trajtim psikiatrit të detyrueshëm. Pasi doli nga institucioni i vuajtjes së dënimit vrau gruan, vajzën dhe veten. Sipas GJEDNJ autoritetet kroate nëëktë rast, kishin dështuar të merrnin masat e duhura për të mbrojtur jetën e viktimave pavarësisht se ishin në dijeni të eksitencës së rrezikut ndaj tyre. Ato nuk kishin kontrolluar administrimin e trajtimit psikiatrit dhe as pas daljes nga burgu nuk kishin bërë kontrolle mjekësore për të hetuar nëse Branko përbënte rrezik apo jo dhe nëse duhet ta vazhdonte trajtimin. **Për këtë arsye GJEDNJ vendos që ka shkelje të Nenit 2 të KEDNJ.**

### ■ **Kontrova vs Rumania (31 Maj 2007): Neni 2**

Pas një historie të gjatë abuzimesh fizike dhe psikologjike, përfshirë kërcënime me armë për jetën, bashkëshorti i kërkueses vrau dy fëmijët e mitur dhe vetën.

**GJEDNJ:** *Autoritetet kishin dështuar të mbronin jetën e fëmijëve të aplikantes, pavarësisht se situata në familjen e tyre ishte e njohur nga policia lokale përmes ankesës dhe telefonatave të emergjencës së bëra nga kërkuesja. Policia nuk kishte regjistruar ankesën në këtë rast, nuk kishte hapur hetime dhe nuk e kishte deleguar çështjen për ndjekjen penale të autorit. Si e tillë me vetëdije, në mungesë të mosmarrjes së masave, kishte lejuar ardhjen e pasojave.*

52 Vendimet e jurisprudencës janë shkëputur nga European Court of Human Rights, Factsheet-Domestic Violence, Janar, 2018.

■ ***Eremia dhe të tjerë kundër Republikës së Moldavisë ( 28 Maj 2013): Neni 3/8/14***

Çështja ngre shqetësimin e mungesës së veprimit të autoriteteve për të mbrojtur aplikanten nga sjelljet abuzuese të bashkëshortit dhe babait që ishte njëkohësisht oficer policie. Oficeri ipolicisë vinte në shtëpi në gjendje të dehur dhe ushtronte dhunë fizike ndaj aplikantes në prani të vajzave të mitura. Vajzat si rrjedhojë vuanin pasojat psikologjike.

Autoritetet moldave happennjë hetim ndaj oficerit të policies, i cili u ndërpre pa arsye për një vit, me arsyetimin se do të rivazhdonte nëse gjatë kësaj periudhë përsëritej sërish e njëjta sjellje e tij.

**GJEDNJ vendos se:**

- ◆ Ka Shkelje e Nenit 3 të KEDNJ në lidhje me nënën nisur nga fakti se pavarësisht provave të mjaftueshme të abuzimit, autoritetet nuk morrën masa të mjaftueshme edhe pse bashkëshorti përbënte rrezik për gruan dhe vajzat e tij.
- ◆ Ka shkelje të Nenit 8 në lidhje me vajzat.
- ◆ Ka shkelje të Nenin 14 në lidhje me Nenin 3: Dështimi i autoriteteve për të mbrojtur nënën përbën shkelje të aplikantes për të gëzuar mbrojtje të njëjtë nga ligji. Sipas Gjykatës veprimet e autoriteteve nuk kishin qënë vetëm një dështim ose vonesë e për të ndjekur dhunën ndaj saj, por kishin ndikuar në vazhdimin dhe përsëritjen e gjëndjes abuzuese për të duke reflektuar ekzistencën e një qëndrimi diskriminues të autoriteteve ndaj kërkues. Në këtë drejtim, Gjykata morri parasysh edhe gjetjet e Raporterit Special të Kombeve të Bashkuara sipas të cilit autoritetet nuk e vlerësonin seriozitetin dhe zgjatjen e problemit të dhunës në familje në Republikën e Moldavisë gjë që kishte një efekt diskriminues mbi gratë.<sup>53</sup>

■ ***Opuz kundër Turqisë ( 9 qershor 2009): Neni 2, 3,14***

Aplikanti pretendonte se autoritetet turke kishin dështuar të mbronin të drejtën e jetës së nënës së saj, e cila ishte vrarë nga bashkëshorti i aplikantit dhe se ata kishin qënë të pakujdesshëm përballë dhunës së përsëritur, kërcënimeve me vdekje dhe dëmtimeve ndaj të cilave ajo vetë kishte qënë subjekt. Ajo u ankua gjithashtu për

53 Shih gjithashtu: B. kundër Republikës së Moldavisë (nr.66382/09) dhe Mudric kundër Republikës së Moldavisë, gjykimet e 16 korrikut 2013; N.A. kundër Republikës së Moldavisë (nr. 13424/06), gjykimi i 24 shtatorit 2013; T.M. dhe C.M. v. Republika e Moldavisë, gjykimi i 28 janarit 2014.

mungesën e mbrojtjes së grave kundër dhunës në familje sipas ligjit të brendshëm turk.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 2 (e drejta e jetës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me vrasjen e nënës së kërkuesit dhe shkelje të nenit 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues) të Konventës në lidhje me dështimin e shtetit për të mbrojtur aplikantin. Gjithashtu, për here të parë në një rast të dhunës në familje, konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës në lidhje me nenet 2 dhe 3. Në këtë aspekt, Gjykata vuri në dukje, se dhuna ndikoi kryesisht tek gratë, ndërkohë që pasiviteti gjyqësor i përgjithshëm dhe diskriminues në Turqi krijoi një klimë që ishte e favorshme për të. Dhuna e pësuar nga kërkuesi dhe nëna e saj mund të konsiderohet se ka qenë e bazuar në gjini dhe diskriminuese ndaj grave. Për më tepër, përkundër reformave të kryera nga Qeveria turke në vitet e fundit, reagimi i përgjithshëm i sistemit gjyqësor dhe mosndëshkimi që gëzojnë agresorët, si nërastin e aplikantit, treguan një angazhim të pamjaftueshëm nga ana e autoriteteve për të ndërmarrë veprimet e duhura për të adresuar dhunën në familje.

### ■ ***M kundër Kroacisë (aplikimi nr.55164 / 08), 14 tetor 2010: Neni 8***

Ky rast kishte të bënte me ankesën e ankuesit se autoritetet kishin dështuar ta mbronin atë kundër dhunës familjare të ish-bashkëshortit të sëmurë mendërisht, pavarësisht se ajo i kishte njoftuar për sulmet e përsëritura fizike dhe verbale dhe kërcënimet me vdekje. Ajo gjithashtu pretendoi se ligjet përkatëse në Kroaci lidhur me dhunën në familje ishin diskriminuese.

Gjykata deklaroi ankesën e ankuesit sipas nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës të papranueshme, veçanërisht për faktin se ajo nuk kishte dhënë dëshmi të mjaftueshme (siç janë raportet apo statistikat) për të vërtetuar se masat ose praktikatat e miratuara në Kroaci kundër dhunës në familje, ose efekteve të këtyre masave ose praktikave, ishin diskriminuese.

Më tutje konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës në atë që autoritetet kroate kishin dështuar të zbatojnë shumë nga masat e urdhëruara nga gjykatat për të mbrojtur kërkuesin ose për t'u marrë me problemet psikiatrike të ish burrit, të cilat duket se ishin rrënjët e sjelljes së tij të dhunshme.

### ■ ***Rumor kundër Italisë(27 maj 2014): Neni 3,14***



Aplikanti u ankua se autoritetet nuk e kishin mbështetur atë pas incidentit të rëndë të dhunës në familje kundër saj apo për ta mbrojtur atë nga dhuna e mëtejshme. Ajo gjithashtu pohoi se këto dështime kanë qenë rezultat i pamjaftueshmërisë së kornizës legjislative në Itali në fushën e luftës kundër dhunës në familje dhe se kjo e ka diskriminuar atë si grua.

Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues) të Konventës, vetëm dhe në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit). Gjykata konstatoi se autoritetet italiane kishin vendosur një kornizë legjislative që u lejonte atyre të marrin masa ndaj personave të akuzuar për dhunë në familje dhe se kjo kornizë kishte qenë efektive në dënimin e kryerësit të veprës penale për të cilën kërkuesi ishte viktimë dhe në parandalimin e përsëritjes së dhunës kundër integritetit fizik të saj.

■ ***M.G. kundër Turqisë (nr.664 / 10), (22 mars 2016): Neni 3, 14***

Ky rast kishte të bënte me dhunën familjare që përjetohej nga ankuesi gjatë martesës së saj, kërcënimet e bëra ndaj saj pas divorcit të saj dhe proëedurave pasuese. Në veçanti, kërkuesi i kritikoi autoritetet vendase për dështimin në parandalimin e dhunës së cilës ajo i ishte nënshtruar. Ajo gjithashtu u ankua për diskriminim të përhershëm dhe sistematik në lidhje me dhunën kundër grave në Turqi.

Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues) të Konventës, duke pranuar se mënyra në të cilën autoritetet turke kishin kryer procedimet penale nuk mund të konsiderohej si përmbushje e kërkesave të nenit 3. Ajo gjithashtu konsideroi se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës së lexuar në lidhje me nenin 3, duke pranuar se pas shpalljes së divorcit (më 24 shtator 2007) dhe deri në hyrjen në fuqi të një ligji të ri (nr.6264) më 20 mars 2012, korniza legjislative në fuqi nuk garantonte që aplikanti, i divorcuari, të përfitonte nga masat mbrojtëse dhe vuri në dukje se për shumë vite pas aplikimit në gjykatat kombëtare, ajo ishte detyruar të jetonte në frikën e sjelljes së ish-burrit të saj.

■ ***Halime Kılıç kundër Turqisë (28 qershor 2016) : Neni 2,14***

Ky rast kishte të bënte me vdekjen e vajzës së aplikantit, i cili u vra nga bashkëshorti i saj edhe pse kishte parashtruar katër ankesa dhe mori tre urdhra për mbrojtje dhe masa ndaluese.

Gjykata deklaroi se kishte pasur shkelje të nenit 2 (e drejta për jetë) dhe shkelje të

nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të marra së bashku me nenin 2 të Konventës. Ajo gjeti në veçanti se procedurat e brendshme nuk kishin arritur të plotësonin kërkesat e nenit 2 të Konventës duke siguruar mbrojtje për vajzën e aplikantit. Duke dështuar në ndëshkimin e burrit të aplikantit për të përmbushur urdhrat e lëshuara kundër tij, autoritetet kombëtare kishin tejkaluar çdo efektivitet të urdhrave duke krijuar kështu një kontekst të mosndëshkimit, duke bërë të mundur që ai të sulmonte vazhdimisht gruan e tij pa ju kërkuar llogari. Gjykata gjithashtu e gjeti të papranueshme që vajza e kërkueses kishte mbetur pa burime apo mbrojtje kur u përball me sjelljen e dhunshme të burrit të saj dhe se duke bërë syrin e verbër ndaj akteve të përsëritura të dhunës dhe kërcënimeve me vdekje ndaj viktimës, autoritetet kishin krijuar një klimë që ishte e favorshme për dhunën në familje.

■ ***Talpis kundër Italisë (2 mars 2017): Neni 2,3,14***

Ky rast ka të bëjë me dhunën bashkëshortore të pësuar nga kërkuesi, gjë që rezultoi në vrasjen e djalit të saj dhe vrasjen e saj në tentativë.

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 2 (e drejta për jetë) të Konventës për shkak të vrasjes së djalit të kërkuesit dhe vrasjes së saj në tentativë. Gjithashtu konsideroi se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues) të Konventës për shkak të dështimit të autoriteteve në detyrimin e tyre për të mbrojtur aplikantin kundër veprimeve të dhunës në familje. Së fundmi, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës në lidhje me nenet 2 dhe 3, duke gjetur se dhuna e shkaktuar ndaj aplikantit duhet të konsiderohet e bazuar në seks dhe se rrjedhimisht arriti në një formë të diskriminimit ndaj grave. Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje në veçanti se kërkuesi kishte qenë viktimë e diskriminimit si grua për shkak të mosveprimit të autoriteteve, të cilat e kishin nënvlerësuar dhunën në fjalë dhe në këtë mënyrë kishin miratuar në thelb atë.

## KREU III

### Procesi i rregullt dhe ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave (neni 6/1 i KEDNJ-së).

#### Jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe mësimet për shqipërinë.

---

##### 1. Ekzekutimi i vendimit të gjykatës, pjesë integrale e procesit të rregullt.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është një pjesë integrale e procesit të rregullt gjyqësor, në kuptimin e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo është shprehur qartë në vendimin *Horsby vs. Greece* nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka theksuar se, “*Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga Gjykata duhet të konsiderohet si pjesë integrale e ‘procesit’ për qëllimet e artikullit 6 (art. 6)*”<sup>54</sup>.

Faza e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është vendimtare për efektivitetin e të gjithë procesit gjyqësor dhe ndikon fuqimisht në besueshmërinë e publikut ndaj pushtetit gjyqësor dhe ndaj vetë Shtetit të së Drejtës. Edhe pse e vendosur në përfundim të procesit, ekzekutimi i vendimit përfaqëson një çështje të aksesit në drejtësi po aq të rëndësishme, sa edhe vetë procesi. Prandaj, mbarëvajtja e kësaj faze përcakton suksesin e procesit dhe performancën e sistemit të drejtësisë.

---

54 Shih: *Case of Horsby vs. Greece*, (Application no. [18357/91](https://hudoc.echr.coe.int/eng)), Judgment, 19.03.1997, available at: <https://hudoc.echr.coe.int/eng>, paragrafi 40.

### 1.1. Jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi procesin e rregullt (neni 6 I KEDNJ); Mësimi për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë dhe institucionet e tjera. *Qufaj CO SHPK kundër Shqipërisë.*

GJEDNJ-ja e ka vlerësuar ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave në fushën civile e administrative, si një pjesë integrale e “të drejtës për gjykatë” në kuadrin e procesit të rregullt. Në çështjen *Hornsby vs. Greece*<sup>55</sup>, GJEDNJ-ja, krijoi praktikë të re duke konsideruar ekzekutimin e vendimit gjyqësor si një çështje e procesit të rregullt<sup>56</sup>. Më tej ajo e thelloi arsyetimin edhe në çështje të tjera, duke i dhënë jurisprudencës së saj përmasa efektive me qëllim shndërrimin në realitet të ekzekutimit të vendimit. Sipas Gjykatës, do të ishte e pakonceptueshme që garancitë procedurale që burojnë nga art 6/1 i Konventës të kuptohen vetëm me aksesin në Gjykatë. “...*Kjo e drejtë do të ishte një iluzion nëse sistemi i brendshëm ligjor i një Shteti anëtar, do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej joveprues në dëm të njërës palë...*”<sup>57</sup>.

Të njëjtin qëndrim iu desh ta përsëriste edhe disa vjet më pas në çështjet *Scordino vs. Italy*, si dhe në çështjen *Qufaj Co shpk vs. Albania*. Në këtë të fundit, GJEDNJ-ja e ritheksoi shprehimisht qëndrimin që kishte mbajtur në çështjen *Hornsby*, si vijon: “Gjykata pohon se neni 6/1 I siguron kujtdo të drejtën për t’u ankuar në Gjykatë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile; pra në këtë mënyrë mishëron “të drejtën për proces të rregullt”, ku e drejta për akses, që është e drejta për të filluar një proces gjyqësor për çështje civile, është njëri prej aspekteve të saj. *Kjo e drejtë do të ishte një iluzion nëse sistemi i brendshëm ligjor i një Shteti anëtar, do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej joveprues në dëm të njërës palë*”<sup>58</sup>.

Në këtë vendim, GJEDNJ risolli në vëmendje edhe respektimin e afatit të arsyeshëm në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Sipas arsyetimit të saj “...*një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta. Por, vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës të mbrojtur nga artikulli 6/1*”<sup>59</sup>.

55 See: “*Guide on article 6 of the ECHR*” (Right to fair trial, Civil Limb), Council of Europe, last update 31.12.2018, fq. 37, paragrafi 157; i vefshëm në

56 *Case of Hornsby vs. Greece*, cited.

57 Idem

58 Shih: *Case of Qufaj CO.SH.P.K. v. Albania*, (*Application no. 54268/00*), final Judgment 30.3.2005, available at <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-67514%22%5D%7D>; paragrafi 38.

59 Idem.

Një nga mësimit më të rëndësishme drejtohet për Gjykatën Kushtetuese në Shqipëri, pasi në lidhje me kërkesën e Qufajt kjo Gjykatë kishte vendosur moskalimin e çështjes për gjykim me arsyetimin se objekti i çështjes nuk ishte në juridiksionin e kësaj gjykate. Por, sipas arsytimit të GJEDNJ-së: "... Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte kërkesën e shoqërisë ankuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, si pjesë të juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për një proces të rregullt ligjor"<sup>60</sup>. Mbi këtë bazë, arrijmë në konkluzionin se, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një çështje e kontrollit kushtetues në kuadrin e ankimit kushtetues individual si përbërëse e aksesit në drejtësi.

Mbrojtjen e së drejtës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë si një pjesë integrale të nenit 6/1 të Konventës, GJEDNJ e ka konsoliduar edhe në raste të tjera kundër Shqipërisë, nga arsyetimi i të cilave mund të evidentojmë qartë problemet që shtrohen si shkelje, përgjegjësitë e institucioneve, si dhe të nxjerrim mësimit për Shqipërinë<sup>61</sup>. Në këto vendime institucionet vështrojnë përgjegjësitë përkatëse, të cilat shtrihen jo vetëm ndaj institucioneve që kanë kompetencw ekzekutimin e vendimit (siç janë zyrat e përmbarimit), por edhe institucionet e tjera shtetërore veprimtaria e të cilave lidhet me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Gjithashtu, në disa vendime të GJEDNJ-së, konstatojmë se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile në fushën familjare varet në një shkallë të konsiderueshme nga ekzistenca e sistemeve efektive të mbrojtjes që janë të afta të veprojnë jo vetëm brenda vendit, por edhe në bashkëpunimin ndërkombëtar. P.sh, mësimit që burojnë nga *Bajrami vs. Albania* në këtë këndvështrim janë mjaft të rëndësishme dhe aktuale, pasi mund të zbatohen në bashkëpunimin ndërkombëtar midis shteteve për implementimin e mjeteve dhe mundësive që ofrojnë Konventat ndërkombëtare në këtë fushë.

**a. Jurisprudenca e GJEDNJ-së në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore mbi nenin 6 dhe 8 të Konventës. Mësimit për institucionet shqiptare. *Bajrami kundër Shqipërisë dhe Qama kundër Shqipërisë & Italisë.***

*Bajrami kundër Shqipërisë*<sup>62</sup>. Duke përmbledhur shkurtimisht rrethanat e rastit, nënvizojmë se, ankuesi kishte kryer procedurat e divorcit përpara gjykatës shqiptare

60 Paragrafi 42

61 See: *Beshiri vs. Albania* (Application no. 7352/03), *Gjyli vs. Albania* (Application no. 32907/07), *Bajrami vs. Albania* (Application no. 35853/04), *Sharrxhi and others vs. Albania*, (Application no. [10613/16](#)); etj.

62 Case of *Bajrami v. Albania*, (Application no. [35853/04](#)), *Judgement*, 12.12.2006, available at: e vlefshme në gjuhën shqipe në: [www.avokaturashetit.gov.al](http://www.avokaturashetit.gov.al)

dhe me vendimin gjyqësor të muajit shkurt 2004 kishte fituar të drejtën për të ushtruar kujdestarinë për rritjen dhe edukimin e fëmijës. Por, ky vendim, edhe pse ishte i vlefshëm, mbeti i pazbatuar për një periudhë përafërsisht dy vjet<sup>63</sup>, periudhë gjatë së cilës ankuesi, babai i fëmijës, nuk realizoi as të drejtën për t'u takuar me fëmijën. Zyra e përmbartimit shtetëror e justifikonte këtë vonesë, me faktin se ishte në pamundësi për të ekzekutuar vendimin, pasi nëna e vajzës së bashku me fëmijën ishin larguar për në shtetin fqinj, Greqi. Autoritetet shtetërore shqiptare paraqitën përpara GJEDNJ-së argumentin se F.M-ja nuk kishte një status të ligjshëm në Greqi dhe me këtë supozim nuk kishin marrë asnjë masë për të konfirmuar vendndodhjen e F.M-së nga autoritetet greke, edhe pse kjo ishte një mundësi e garantuar nga marrëveshja dypalëshe ndërmjet dy vendeve<sup>64</sup>.

*Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë*<sup>65</sup>. Ankuesi ka një djalë i cili ka lindur më 25 Gusht 1994. Në Shtator 1999 bashkëshortja e ndjerë e ankuesit, e cila vuante nga një sëmundje e rëndë, hyri në Itali në mënyrë të parregullt, së bashku me të birin, me qëllim që të merrte trajtim mjekësor. Në një datë të pacaktuar ankuesi u bashkua me bashkëshorten dhe djalin e tij në Itali. Por, pas mosmarrëveshjeve me të afërmit e bashkëshortes, ankuesi u dëbua nga Italia meqenëse nuk kishte leje qëndrimi. Bashkëshortja e tij dhe i biri, situata e të cilëve nuk ishte rregulluar ende, vazhduan të qëndrojnë në Itali. Bashkëshortja e tij vdiq më 7 Tetor 2002. Ankuesi pretendonte, në veçanti, se ka patur shkelje të Neneve 6 § 1 dhe 8 si rezultat i dështimit nga ana e autoriteteve Shqiptare dhe Italiane për të siguruar të drejtën e kontaktit me djalin e tij në Itali. Në këtë rast, Gjykata Evropiane ka pranuar kërkesën e Qamës kundër Shqipërisë dhe ka rrëzuar kërkesën e tij kundër Italisë, pasi ai nuk ka shteruar mjetet e brendshme sipas legjislacionit italian.

**Masat pozitive për ekzekutimin e vendimit.** Për sa më sipër, është e rëndësishme të evidentojmë marzhin e veprimit shtetëror për të realizuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor bazuar në interpretimin e GJEDNJ-së në bazë të Konventës. Kjo e fundit, ka theksuar se përveç faktit që shteti ka detyrën të mbrojë individin prej veprimeve arbitrare të autoriteteve publike, ka edhe detyrime pozitive të qenësishme për

63 *Bajrami vs. Albania* (Application no. 35853/04), paragrafi 58.

64 The “*Bilateral Agreement on Mutual Assistance in Civil and Criminal Matters between Greece and Albania*”, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 7760, 14.10.1993 dhe nga Greqia me ligjin nr. 23.11.1995. Artikujt 2, 3, 23 dhe 24 të Marrëveshjes parashikohet mundësia për Ministrinë e Drejtësisë së të dyja vendeve kontraktuese të bashkëpunojnë për njohjen dhe bashkëpunimin në territoret respektive të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna nga autoritetet e palës tjetër në çështjet civile familjare dhe tregtare. (*Case of Bajrami v. Albania*, paragrafi 33)

65 *Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë*, Ankimi nr. 4604/09, vendimi i vlefshëm në gjuhën shqipe, përkthim zyrtar në: [www.avokaturashetit.gov.al](http://www.avokaturashetit.gov.al)

respektimin efektiv të jetës familjare<sup>66</sup>. Në këtë kuadër, ankuesi duhet të ndërmarrë masat me qëllim ribashkimit të tij me fëmijën, kurse organet shtetërore duhet ta lehtësojnë këtë ribashkim (paragrafi 51). Nga ky pikëvështrim mund të përcaktojmë se cilat do të ishin masat pozitive, të nevojshme a të përshtatshme.

Në rastin Bajrami, masat e nevojshme/të përshtatshme dhe masat pozitive lidhen me efektivitetin e bashkëpunimit ndërshtetëror Shqipëri-Greqi, pasi shkaku kryesor për mosekzekutimin e vendimit i paraqitur nga autoritetet e shtetit shqiptar ishte pamundësia e kontaktimit të të paditurës, për shkak se ishte larguar në Greqi dhe qëndronte atje në mënyrë të paligjshme. Ky bashkëpunim mund të vendoset mbi bazën e konventave ndërkombëtare, ose mbi bazën e marrëveshjeve bilaterale midis të dyja shteteve. Në këtë rast, është fjala për Konventën e Hagës mbi Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve. Por, deri në gjykimin e kësaj çështjeje nga GjEDNJ, Shqipëria nuk e kishte ratifikuar këtë Konventë. Kjo Konventë u ratifikua nga Shteti Shqiptar në vitin 2005, kur çështja Bajrami ishte ende në proces gjykimi<sup>67</sup>. Megjithatë, ekzistonte Konventa e bashkëpunimit në çështjet civile e penale midis Shqipërisë dhe Greqisë<sup>68</sup>, e cila nuk u vu në zbatim nga autoritetet shqiptare.

Ankuesi parashtroi pretendimin se organet kompetente kishin neglizhuar të bënin ato përpjekje që priteshin normalisht prej tyre për të garantuar respektimin e të drejtave të tij. Ai pretendonte gjithashtu, që *dështimi i organeve kompetente për të përfshirë edhe organet përkatëse Greke në ndihmë të gjetjes së vendndodhjes së të bijës mbështetëj në supozimin e tyre se F.M. dhe bashkëshorti i saj aktual ishin residentë të paligjshëm në Greqi dhe nuk mbështetëj mbi fakte të bazuara*. (paragrafi 48). Nga ana e tyre, autoritetet shqiptare e kundërshtuan këtë pretendim të ankuesit, me argumentin se, *“se meqenëse nuk ishte dhënë adresa e saktë e fëmijës dhe nënës së saj në Greqi, përdorimi i instrumenteve të parashikuara në marrëveshjen dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë kishte qenë jo efikas.”* (paragrafi 49).

Probleme në ndërmarrjen e masave pozitive me qëllim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore kur pala debitore ndodhet jashtë vendit, u shtruan edhe në çështjen Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë. Në përfundim të gjykimin të themelit të kësaj çështjeje GjEDNJ-ja ka konkluduar se, *“...meqenëse të dy prindërit kanë rënë dakord me dëshirën e tyre për të udhëtuar me fëmijën në Itali dhe meqenëse fëmija mbeti në Itali në bazë të urdhrin të ligjshëm të dhënë nga gjykata Italiane e cila nuk i njohu ankuesit*

66 *Bajrami vs. Albania*, paragrafi 50

67 Ratifikuar me Ligjin Nr. 9446, datë 24.11.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën, “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës””.

68 Konventë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë mbi ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale” cituar.

të drejtat e kujdestarisë, nuk kishte detyrim pozitiv për Shqipërinë për të marrë hapa për të siguruar zbatimin e të drejtave të kontaktit të ankuesit me djalin e tij siç njihet nëpërmjet vendimit të gjykatës Shqiptare. Ankuesi duhet të kishte depozituar padi pranë gjykatës Italiane për të fituar të drejtat e kontaktit ose vizitave në lidhje me djalin e tij<sup>69</sup>. Kjo dëshmon dobësinë e gjyqësorit shqiptar për të dhënë vendime efektive që e adresojnë palën në juridiksionin e duhur. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për organet përmbartimore shqiptare.

Çështja e efektivitetit të bashkëpunimit bilateral është shtruar edhe në raste të tjera në Shtetin shqiptar. Madje, ky ka mbetur ende një shqetësim i pazgjidhur, jo vetëm kur ka qenë rasti i zbatimit të marrëveshjeve bilaterale të Shtetit Shqiptar me Greqinë, por edhe për zbatimin e konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Shtetit shqiptar. Mbetet ende një mendësi në Ministrinë e Drejtësisë, madje dhe në gjykatat shqiptare, që adresa e saktë e debitorit jashtë vendit të sigurohet nga personi i interesuar. Pamundësia e kërkuarit në gjykatë për të paraqitur një adresë të tillë është bërë në disa raste shkak për pushimin e gjykimit ose për mosveprimin e Ministrisë së Drejtësisë<sup>70</sup>. Mendojmë se kjo masë pozitive duhet të ndërmerret nga vetë autoritetet shtetërore që kanë detyrimin të ekzekutojnë vendimin e gjykatës.

## 2. Ekzekutimi i vendimeve të GjEDNJ-së në Shqipëri.

### 2.1. Rihapja e proceseve gjyqësore mbi bazën e vendimit të GJEDNJ-së.

Në këtë pjesë kemi për qëllim të bëjmë të njohur ndryshimet që kanë ndodhur në legjislacionin shqiptar për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së për Shqipërinë.

Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ-së është një proces i rëndësishëm për vendosjen në vend të të drejtave të shkelura dhe përmirësimin e performancës së të gjitha institucioneve të vendit në drejtim të respektimit të tyre. Ky angazhim buron nga neni 46 i KEDNJ-së, i cili parashikon fuqinë detyruese të vendimeve dhe procedurat për ekzekutimin e tyre, duke përcaktuar Këshillin e Ministrave si organin përgjegjës për mbikëqyrjen e këtij procesi.

Rekomandimi R (2000), 2 i Komitetit të Ministrave mbi rihapjen e çështjeve gjyqësore në sistemin kombëtar, pas dhënies së një vendimi nga GJEDNJ, inkurajon shtetet që të aplikojnë maksimalisht *restitutio in integrum*. Kjo gjë shpesh mund të arrihet vetëm

69 Qama kundër Shqipërisë, paragrafi 88.

70 Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nr. 13-2014-7950, dt. 1/8/2015



nëpërmjet formës së rihapjes së çështjeve, prandaj dhe sistemet ligjore kombëtare duhet të garantojnë këtë instrument. Ky komitet ka inkurajuar shtetet që atëherë kur GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të KEDNJ-së lidhur me shkelje tepër serioze me pasoja negative, për shkak të vendimeve të sistemit vendas, të cilat nuk mund të jenë efektive vetëm me dëmtshpërblimin, por duhet të rihapin çështjet gjyqësore. Rihapja e proceseve është parë në këndvështrimin e të respektuarit të parimit të *restitution in integrum*, në mënyrë të plotë për aq sa është e mundur<sup>71</sup>. “Kërkesat e nenit 46 të KEDNJ-së, kanë gjetur zbatim gjerësisht në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila e ka konsideruar dështimin tërësor ose të pjesëshëm të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së si burimin e përgjegjësisë ndërkombëtare të shtetit pale...”<sup>72</sup>. Shtetet palë kanë detyrimin jo vetëm të shlyejnë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrin masa të përshtatshme për t'i dhënë fund shkeljes së gjetur nga gjykata, me qëllimin që për aq sa është e mundur, kërkuesi të rikthehet në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja.

Për sa më sipër, në Shqipëri janë bërë ndryshime ligjore të rëndësishme që bëjnë të mundur riçeljen e proceseve gjyqësore. Fillimisht, legjislacioni procedural shqiptar nuk parashikonte mundësinë e rishikimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatës për këtë shkak. Megjithatë, në disa raste, rihapja e proceseve gjyqësore u bë e mundur përmes vetë jurisprudencës kushtetuese dhe asaj gjyqësore. P.sh., në çështjen me kërkues *Xheraj*, përpara Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë (2011), GJK ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë me arsyetimin se, edhe pse sistemi penal shqiptar nuk parashikonte një rishikim të vendimeve përfundimtare nëpërmjet rihapjes së procesit, Gjykata e Lartë duhet të zbatonte drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ-në, duke rihapur procesin në rastet kur ishin konstatuar shkelje serioze të procesit të drejtë nga GJEDNJ-ja. Në këtë mënyrë, pati raste kur kjo çështje u zgjidh nga vetë jurisprudenca e gjykatave, por ndryshimet e legjislacionit në kuadrin e Reformës në drejtësi, sollën edhe parashikimet e nevojshme ligjore për rihapjen e procesit në procesin penal e madje, edhe në procesin Kushtetues<sup>73</sup>.

71 Për më gjerë shih: Elsa Toska, “Udhërrëfyes i dimensionit kushtetues të *res judicata* sipas praktikës së gjykatës kushtetuese”, material trajnimi për shkollën e Magjistraturës.

72 Valbona Pajo, Ekzekutimi i Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që Lidhen me Procedimet Penale: *Vështrim krahasues mbi rihapjen e procesit penal në nivel kombëtar*. Revista Shqiptare për Studime Ligjore Vol. 5(2013), i vlefshëm në: <http://www.ajls.org/doc/4RihapjaProcesitPenal.pdf>

73 Në lidhje me rihapjen e proceseve penale shih: “E drejta për proces të rregullt dhe rihapja e proceseve penale. Manual trajnimi mbi nenin 6 të KEDNJ-së”, e vlefshme në: <https://rm.coe.int/training-manual-on-the-right-to-fair-trial-and-reopening-of-domestic-p/16808b7cab>

### 1.2. Rihapja procesit gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të detyrimeve që rrjedhin nga vendimmarrja e gjykatave ndërkombëtare.

#### 2.2.1 Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Rihapja e procesit gjyqësor pranë Gjykatës Kushtetuese mbi bazën e vendimit të GJEDNJ-së mund të bëhet vetëm mbi bazën e kërkesës. Në këtë rast, subjekti i cenuar në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesit gjyqësor (neni 71/c, paragrafi 3)<sup>74</sup>.

Ndaj Gjykatës Kushtetuese mund të paraqitet edhe kërkesë për kontrollin abstrakt të ligjit me qëllim që të shfuqizohet ligji ose akti normativ nëse konstaton se nuk ka mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtat e cenuara. (neni 71/c, paragrafi 2).

Kërkesa që i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nga subjekti, duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore të konstatuara prej saj, si dhe kërkimet konkrete. Madje, kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit dhe shfuqizimin e aktit (neni 71/c, paragrafi 4).

#### 2.2.2. Afati

Kërkesa për rihapje të procesit para Gjykatës Kushtetuese paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare.

#### 2.2.3. Kushtet e pranueshmërisë së Kërkesës (neni 71/c, paragrafi 5).

Kërkesa për rihapje të procesit përpara GJK, nuk pranohet nëse:

- a) pasojat e cenimit të të drejtave dhe lirive themelore nuk ekzistojnë më;
- b) gjykata ndërkombëtare ka dhënë një dëmshpërblim, pa e shoqëruar me rihapje të procesit (*just satisfaction*);
- c) cenimi është mënjanuar nga një rregullim i ri ligjor ose forma të tjera.

74 Ligj nr. 8577, dt. 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH-së", i ndryshuar, neni 71/c.

#### **2.2.4. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në rastet e rihapjes së procesit**

(neni 71/c, paragrafi 5).

Pasi ka rihapur procesin në kushtet e detyrimit që rrjedh nga vendimmarrja e gjykatave ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese e rishikon vendimin e saj të mëparshëm dhe mund të vendosë sipas rastit:

- a) Pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj;
- b) Shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe njëkohësisht të aktit që ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të kërkuarit;
- c) Detyrimin e organit kompetent të nxjerrë një akt të ri ose detyrimin e organit të mos veprojë.

#### **2.2.5. Konkurrimi i hapjes së proceseve.**

Pyetja që shtrohet në këtë kuadër është: nëse vendimi i gjykatës ndërkombëtare është dhënë në lidhje me një proces të shqyrtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese edhe nga ajo e zakonshme, në cilën prej gjykatave do të paraqitet kërkesa për rihapje të procesit?

Mund të themi se, Gjykata Kushtetuese nuk është një shkallë e katërt e gjyqësorit. Për rrjedhojë, subjektet do të jenë të interesuara të kërkojnë drejtpërdrejt hapjen e procesit në gjykatën që ka dhënë vendimin formës së prerë. Sidoqoftë, nëse synimi është që të shfuqizohet ligji ose akti normativ mbi të cilin është dhënë vendimi, atëherë është e nevojshme që pala t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Kjo bëhet veçanërisht e domosdoshme kur nuk ka mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtat e cenuara. Megjithatë, kjo pyetje do të marrë përgjigje më të plotë edhe si rezultat i zhvillimit të praktikave të Gjykatës Kushtetuese dhe të asaj që do të thotë në vijim jurisprudenca gjyqësore.

## LITERATURA E KËSHILLUESHME

1. Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights. Right to a fair trial (civil limb), Updated to 30 April 2019, e vlefshme në: [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf)
2. “E drejta për proces të rregullt dhe rihapja e proceseve penale. Manual trajnimi mbi nenin 6 të KEDNJ-së”, e vlefshme në: <https://rm.coe.int/training-manual-on-the-right-to-fair-trial-and-reopening-of-domestic-p/16808b7cab>
3. Valbona Pajo, Ekzekutimi i Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që Lidhen me Procedimet Penale: *Vështrim krahasues mbi rihapjen e procesit penal në nivel kombëtar*. Revista Shqiptare për Studime Ligjore Vol. 5(2013), I vlefshëm në: <http://www.ajls.org/doc/4RihapjaProcesitPenal.pdf>
4. Elsa Toska, “Udhërrëfyes i dimensionit kushtetues të res judicata sipas praktikës së gjykatës kushtetuese”, material trajnimi për shkollën e Magjistraturës.
5. Ursula Kirkelly, “Protecting Children’s Rights under the ECHR: The Role of Positive Obligations”, 61 N. Ir. Legal Q. 245 (2010), e vlefshme në [www.academia.edu](http://www.academia.edu)
6. Diskriminimi i shumëfishtë dhe mekanizmat ligjorë për parandalimin e tij.” (Legjislacioni, praktika dhe roli i organizatave jofitimprurëse), e vlefshme në:  
[http://www.qag-al.org/publikime/diskriminimi\\_shumefishte.pdf](http://www.qag-al.org/publikime/diskriminimi_shumefishte.pdf)

## KREU IV

# Afati i arsyeshëm si pjesë e procesit të rregullt ligjor: nocioni, jurisprudenca dhe ndryshimet ligjore

---

E drejta për një proces të rregullt ligjor e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe e drejta për një gjykim të drejtë e parashikuar në nenin 6.1 të KEDNJ përfshijnë dhe të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Kjo e drejtë konsiston në realizimin e një procesi brenda një periudhe kohore të arsyeshme nga organet përkatëse vendimmarrëse, ose ato të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve. Si jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ashtu edhe jurisprudenca kushtetuese vendase kanë përpunuar mekanizmat për të vlerësuar rastet e cenimit të kësaj të drejte si në proceset civile dhe ato penale. Gjithashtu, në dritën e këtyre zhvillimeve jurisprudenciale janë ndërmarrë dhe një sërë hapash për të përmirësuar kuadrin ligjor procedural, me qëllim përshpejtimin e proceseve gjyqësore, si dhe parashikimin e masave zhdëmtuese në rastet e konstatimit të shkeljeve të kësaj të drejte.

### 1. 1 Standardet e GjEDNJ për «gjykimin brenda një afati të arsyeshëm»

Neni 6 pika 1 KEDNJ parashikon se «çdokush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë». Jurisprudenca e GjEDNJ në lidhje me këtë aspekt të nenit 6 të KEDNJ është e qartë. Hapi i parë është të përcaktohet periudha që duhet të merret në konsideratë, dhe hapi i dytë është të vlerësohet

nëse kjo periudhë mund të cilësohet si «e arsyeshme».<sup>75</sup>GjEDNJ ka përcaktuar dhe detyrimet që palët kontraktuese mbartin për të parashikuar në legjislacionin e tyre mjetet ligjore të përshtatshme dhe efektive për të ofruar zhdëmtimin e duhur palës ndaj të cilës është shkelur detyrimi i garantimit të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, në përputhje me kërkesat e nenit 13 të KEDNj-së.

Palët kontraktuese të KEDNj-së kanë diskrecion për të vendosur mekanizmat që do t'u vihet palës së dëmtuar në dispozicion me qëllim realizimin e *restitutio in integrum* dhe përshpejtimin e procedurave. Sipas GjEDNj-së, mjete të ndryshme ankimore mund të adresojnë shkeljen në mënyrën e duhur. Në vendimin Kudla kundër Polonisë, Gjykata u shpreh si më poshtë: <sup>76</sup>

«Palët kontraktuese të KEDNj kanë detyrimin që të parashikojnë në sistemet e tyre ligjore mjetet për t'u zhdëmtuar nga shkeljet e detyrimit të shqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm të parashikuar në nenin 6 pika 1 të KEDNj, dhe këto mjete ankimore do të duhet të shterohen përpara se subjekti të drejtohet GjEDNj (paragrafi 152.)

«Mjetet në lidhje me tejzgjatjen e procesve gjyqësore duhet të jenë efektive si në «ligj» ashtu edhe në «praktikë». Mjetet janë «efektive» vetëm nëse mbulojnë të gjitha fazat e proceseve, ofrojnë dëmshpërbllim të shpejtë, dhe përshpejtojnë kohëzgjatjen e procedurave në tërësi.

Në vijim të këtij arsyetimi, GjEDNj është shprehur nëçështjen *Scordino kundër Italisë* si në vijim<sup>77</sup>:

*Scordino kundër Italisë*, Aplikimi Nr. 36813/97, datë 29 Mars 2006

“Shtete si Austria, Kroacia, Spanja, Polonia dhe Slovakia kanë zgjedhur të kombinojnë dy tipe masash, një me qëllim përshpejtimin e procedurave, dhe tjetrin për dhënie dëmshpërbllimi. Megjithatë, shtetet mund të vendosin që të parashikojnë vetëm një masë kompensuese, si në rastin e Italisë...Me qëllim zhdëmtimin e palës, mjete ankimore duhet të konsistojnë në një shumë të arsyeshme kompensimi brenda një periudhe kohe, e cila në vetvete është e arsyeshme.”

75 Martin Kujier, *The Right to a Fair Trial and the Council of Europe's Efforts to Ensure Effective Remedies on a Domestic Level for Excessively Lengthy Proceedings*, Human Rights Law Review, 13:4(2013), 777-794, pg. 780

76 Kudla kundër Polonisë, Aplikimi Nr. 30210/96, datë 26.10.2000

77 Këshilli i Evropës, *Mjetet efektive për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore*: Mbështetja e mjeteve të brendshme efektive për zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së, fq. 162

## 1.2. Kriteret e vlerësimit të afatit të arsyeshëm dhe arsyet e vonesave të shkaktuara nga gjykatat

Për sa i përket vlerësimit nëse kjo periudhë kohore ka qënë e arsyeshme, GjEDNj, ka përcaktuar një listë kriteresh të cilët mund të pëmbliidhen si më poshtë:

1. Kompleksiteti i çështjes
2. Sjellja e ankuesit
3. Sjellja e autoriteteve
4. Natyra e të drejtave që i shkelen ankuesit/ Rreziqet që paraqiten për ankuesin

Vlerësimi i këtyre kriterëve bëhet rast pas rasti duke marrë në konsideratë të gjithë aspektet e gjykimit. Në vlerësimin e këtyre kriterëve, GjEDNj duhet të realizojë një balancë të drejtë midis fleksibilitetit të shqyrtimit të kriterëve rast pas rasti, si dhe vendosmërisë për të mos shkaktuar vonesa të cilat «vënë në diskutim efektivitetin dhe besueshmërinë e sistemit të drejtësisë». <sup>78</sup> Gjithashtu, krahas kriterëve të përgjithshëm, elementët specifikë të një çështjeje mund të marrin përparësi. Për qëllime ilustrimi mund të të përmendet rasti kur aplikanti mund të jetë bërë shkaktar për vonesa, por rreziku i tejzgjatjes së një procesi ka qënë shumë i madh për shkak të natyrës tejet sensitive të objektit të gjykimit, si në rastet e gjytimeve me subjekte nëpozitë vulnerabël, përfshirë dhe të miturit.



Përgjithsisht, në bazë të interpretimit konsistent që GjEDNj i ka bërë nenit 6 pika 1 të KEDNj në lidhje me nenin 13, është detyrimi i shtetit që të garantojë një procespa vonesa dhe administrimin e duhur të sistemit të drejtësisë. <sup>79</sup> Megjithatë, realizimi i një procesi brenda një afati të arsyeshëm është një nga sfidat më të mëdha të funksionimit të organeve gjyqësore. Këto sfida i vendosin gjykatat dhe organet e tjera të drejtësisëpara dilemës së realizimi një procesi të shpejtë në kohë, por duke mos anashkaluar asnjë aspekt të procesit që mund të vërë në diskutim respektimin e standardeve të tjera të mirëafirmuara të KEDNj-së. Pavarësisht ngarkesës me të cilën përballen gjykatat, GjEDNj ka pranuar se «mbingarkesa kronike e gjykatave

78 Vernillo kundër Francës, Aplikimi Nr. 11889/85, datë 20 shkurt 1991

79 Lechner dhe Hess kundër Austrisë, Aplikimi Nr. 9316/81, 23 prill 1987

me çështje nuk i justifikon proceset e tejzgjatura.»<sup>80</sup> Gjithashtu, edhe ndryshimet e shpeshta të gjyqtarëve nuk mund të «zhveshin shtetin nga përgjegjësia, duke qënë se është përgjegjës që të sigurojë që administrimi i drejtësisë të jetë i organizuar në mënyrë të përshtatshme.»<sup>81</sup> Po në këtë linjë, GjEDNJ ka saktësuar se vonesat e shkaktuara për shkak të transferimit dhe numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe moszëvendësimit të gjyqtarëve të transferuar, ose të padisponueshëm,<sup>82</sup> ose vonesat e shkaktuara nga mosmarrja në pyetje e palëve, dëshmitarëve, ose të pandehurve nuk justifikohet.<sup>83</sup> Krahas sa më sipër, vonesat e shkaktuara nga gjykatat si pasojë e rishqyrtimit disa herë të të njëjtës çështje si pasojë e gabimeve të gjykatave përbën gjithashtu mangësi serioze të sistemit gjyqësor.<sup>84</sup>

Pavarësisht kësaj, vonesat mund të justifikohen bazuar në natyrën e veçantë të organit që shqyrton aktin.<sup>85</sup> Konkretisht, detyrimi i shteteve që të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në përputhje me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ nuk aplikohet në të njëjtën mënyrë ndaj gjykatës kushtetuese, e cila funksionon si rojtare e kushtetutës gjë e cila e bën të domosdoshme vlerësimin e konsideratave të tjera, si për shembull, rëndësinë politico-sociale të çështjes në fjalë, dhe jo domosdoshmërisht rradhën kronologjike të regjistrimit të çështjes.<sup>86</sup> Po ashtu, kohëzgjatja e një procesi paragykimor para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë nuk mund të merret parasysh në vlerësimin për kohëzgjatjen e procesit, pasi kjo do të ndikonte negativisht në sistemin e krijuar nga e drejta e BE-së.»<sup>87</sup> Po njësoj, periudha e kohës brenda të cilës GjEDNJ pritet të shprehet në bazë të nenit 37 të Rregullores së GjEDNJ për marrjen e masave të përkohshme,<sup>88</sup> ose rastet kur procesi pezullohet kur ndonjë nga gjykatat më të larta të vendit paraqet një kërkesë për një opinion këshillimor në GjEDNJ në përputhje me procedurën e parashikuar në Protokollin e 16 të KEDNJ-së, nuk do të llëgaritet për efekt të vonesave në proces.<sup>89</sup>

80 Probmeister kundër Gjermanisë, Aplikimi Nr. 20950/92, 1 korrik 1992

81 Lechner dhe Hess kundër Austrisë, Aplikimi Nr. 9316/81, 23 prill 1987

82 Nankov kundër Maqedonisë së Veriut, Aplikimi Nr. 26541/02 datë 29 nëntor 2007

83 Roubies kundër Greqisë, Aplikimi Nr. 22525/07, datë 30 prill 2009

84 Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë Aplikimi Nr. 10508/02 datë 23 tetor 2007, Marini kundër Shqipërisë Aplikimi Nr. 3738/02 datë 18 dhjetor 2007, Topallaj kundër Shqipërisë Aplikimi Nr. 32913/03 datë 26 prill 2016, Luli kundër Shqipërisë Aplikimet Nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 and 31355/09 datë 1 prill 2014

85 Süßman kundër Gjermanisë, Aplikimi Nr. 20024, datë 16 shtator 1996

86 Oršuš kundër Kroacisë, Aplikimi Nr. 15766/03, 16 mars 2010

87 Pafitis dhe të tjerë kundër Greqisë, Nr. 20323/92, 26 Shkurt 1998

88 Almir Rapo kundër Shqipërisë, Aplikimi Nr. 58555/10, datë 25 shtator 2012

89 Ratifikuar me Ligj 48/2015 "Për ratifikimin e protokollit 16 të KEDNJ"



Përps sa më sipër, GjEDNj merr në konsideratë dhe përpjekjet e organeve shtetërore për të përshpejtuar procesin, duke përfshirë këtu, *inter alia*, masat e marra nga shteti për të emëruar gjyqtarë/këshilltarë/ndihmës, shtimin e stafit administrativ, etj.

## 2. Afati i arsyeshëm në gjykimin penal

### 2.1 Nocioni "akuzë penale"

Në proceset gjyqësore me akuza penale fillimisht është e udhës të përcaktohet se çfarë do të kuptohet me "akuzë penale". Ashtu si edhe me koncepte të tjera të zhvilluara në jurisprudencën e saj, GjEDNj ka përpunuar një interpretim autonom të këtij termi. Për përcaktimin e pranisë së një "akuze penale" është e nevojshme që të merren parasysh tre faktorë:

- A) cilësimi juridik i masës në legjislacionin vendas (nëse është masë administrative, penale, ose disiplinore)
- B) natyra e masës (shkakton një dëm dhe ka qëllim të dënojë personin dhe jo të paralajmërojë atë)
- C) ashpërsia e dënimit.<sup>90</sup>

Duke pasur parasysh natyrën sensitive të gjykimeve penale, rregulli i përgjithshëm i aplikueshëm është se "Personat e akuzuar nuk duhet të qendrojnë një kohë të gjatë në gjendje pasigurie për të pritur rezultatin e akuzave penale të ngritura kundër tyre".<sup>91</sup> Për këtë arsye, afatet procedurale në një gjykim penal, duhet të jenë më tëshkurtra se ato në një gjykim civil.

### 2.2 Llogaritja e afateve në procesin penal

Llogaritja e fillimit dhe përfundimit të afatit është thelbësore, pasi në bazë të saj mund të përcaktohet nëse do të ketë tejkalim afati, dhe nëse ky tejkalim do të konsiderohet si i arsyeshëm. Periudha që duhet të merret në konsideratë fillon në ditën që personi "ngarkohet me akuzën". Sipas jurisprudencës, termi "ngarkim me akuzë" mund të përkufizohet përgjithësisht si "një njoftim zyrtar dhënë një individ nga autoriteti kompetent mbi dyshimet se ka kryer një vepër penale". Megjithatë, në disa raste mund të marrë dhe "formën e masave të tjera të cilat kanë të njëjtat pasoja me këto dhe që cenojnë situatën e të dyshuarit në mënyrë të ngjashme." Pra, momenti i

90 Engel kundër Hollandës, Nr. 5370/72, 8 Qershor 1976

91 Wemhoff kundër Gjermanisë. Aplikimi Nr. o 2122/64, datë 27 Qershor 1968

fillimit do të konsiderohet kur i akuzuari "preket në mënyrë thelbësore".<sup>92</sup> Në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të përmbledhur rrethanat në të cilat konsiderohet se kur fillon dhe kur përfundon periudha kohore brenda të cilës i akuzuari konsiderohet se "preket në mënyrë thelbësore" sipas jurisprudencës së GjEDNJ<sup>93</sup>:

Nisja e afatit	Përfundimi i afatit
Data e nisjes së hetimeve paraprake Data e lëshimit të urdhërit të arrestit Data e ekzekutimit të urdhërit të arrestit Data e heqjes së imunitetit parlamentar Data e marrjes njoftim për nisjen e procedimit penal Data e konfirmimit se njoftimi i akuzës është bërë Data është caktuar një mbrojtës Data e vendimit të konfiskimit të një asemi	Data e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë që shprehet mbi akuzën (duke përfshirë dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese)

## 2.3 Kriteret për vlerësimin e afateve

Kohëzgjatja e procesit në terma kohorë për se nuk është e mjaftueshme për të përcaktuar nëse do të ketë shkelje të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Në përputhje me rrethanat specifike të çdo çështjeje, GjEDNJ analizon analizojë kriteret e përmendur në pikën 1.2, të cilët në një proces penal, mund të përmbledhen si më poshtë:

Kompleksiteti i çështjes	Risku për kërkuesin
Numri i të pandehurve ose viktimave Natyra e akuzave të ngarkuara ndaj të pandehurit/pandehurëve Numri i lartë i dokumenteve që duhet të shqyrtohen Vlerësimi i mundësisë për të thirrur një ekspert ose kryerja e një eksperimenti	"Kujdes" i vecantë për subjektet në paraburgim <sup>94</sup> Risk me natyrë pasurore

92 Ivana Roagna, *The right to trial within reasonable time under Article 6 ECHR*, A practical handbook, 2018, fq. 17, cituar çështje si Foti dhe të tjerë kundër Italisë Aplikimi Nr. 7604/76; 7719/76; 7781/77; 7913/77 datë 10 dhjetor 1982, Corigliano dhe të tjerë kundër Italisë Aplikimi Nr. 8304/78 datë 10 dhjetor 1982, Merit kundër Ukrainës Aplikimi Nr. 66561/01, datë 30 mars 2004, Tychko kundër Rusisë Aplikimi Nr. 56097/07, 11 Qershor 2015

93 *Ibid.* fq.

94 ablonski kundër Polonisë, Aplikimi Nr. 33492/96, datë 21.12.2000

Çështje të tjera të lidhura me provën dhe marrjen e provës Nevoja e shkëmbimit të informacionit në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja	Risk me natyrë jopasurore (çështje të lidhura me grupe vulnerabël, viktimat e trafikimit, viktimat të mitur në proces etj.) <sup>95</sup>
<b>Sjellja e autoriteteve</b>	<b>Sjellja e palës</b>
Kompleksiteti organizativ dhe funksional i prokurorisë, gjykatave, sekretarisë gjyqësore Marrja e informacionit nga autoritetet e tjera Vonesa në administrimin e provave/thirrjen e dëshmitarëve/kryerjen e ekspertimeve Vonesa në njoftime Vonesa në pushimin e procedimit penal	Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit Ndryshime të shpeshta të përfaqësimit Kërkesa të pabaza për mungesë juridiksioni/kompetence Nënshtrimi ndaj një ekzaminimi mjekësor

## 2.2 Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm në procesin penal nga optika e Gjykatës Kushtetuese

Nga jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese janë evidentuar disa raste kur kjo e fundit ka gjykuar mbi tejzgjatejen e procesit në gjykimet penale. Në vijim janë shkëputur disa raste dëshmojnë për dinamikat e çështjeve të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese dhe *ratio* e saj në secilën prej tyre. Në një nga rastet më komplekse të paraqitura përpara kësaj Gjykate, kjo e fundit shprehet<sup>96</sup> :

"Nga një shqyrtim i hollësishëm i materialeve të dosjes gjyqësore është i kuptueshëm kompleksiteti i procesit gjyqësor në fjalë, duke pasur parasysh numrin e të pandehurve dhe të akuzave të veçanta për secilin, rrethanat e çështjes, kohën që i është dashur prokurorisë për mbledhjen e provave dhe formulimin e akuzave. Gjykata çmon se në zgjatjen e procesit ka ndikuar edhe fakti që kjo çështje, mbi bazën e ankimeve, ka kaluar dy herë të gjitha instancat gjyqësore.

"Gjykata vlerëson se kompleksiteti i çështjes, sjellja e organit procedues dhe e kërkuesit janë bërë shkak për zgjatjen e procesit gjyqësor tej afateve të arsyeshme. Pavarësisht se vonesat, që i atribuohen organit procedues, kanë ndodhur për shkaqe objektive dhe hapësirat legjislative kanë lejuar rishqyrtimin e çështjes, në çmuarjen e Gjykatës, zvarritja e procesit nga autoritetet shtetërore është e pajustificueshme."

95 Ristić kundër Serbisë, Aplikimi Nr. 32181/08, datë 18.04.2011

96 Gjykata Kushtetuese, Vendim 47/2011

Në këtë rast Gjykata Kushtetuese, mori në konsideratë si vështirësitë e asociuara me gjykimin në mungesë, nevojën e shkëmbimit të informacioneve me autoritetet e huaja, mungesën e avokatëve, por pavarësisht këtyre rrethanave, të gjitha argumentet e përmendura sa më sipër nuk justifikojnë zgjatjen e procesit penal për afro 13 vjet.

Gjithashtu, në një tjetër vendim Gjykata Kushtetuese në Mbledhjen e Gjyqtarëve konstaton dhe aspekte që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuesit në proces. Kjo sjellje konsiderohet përcaktuese për të vendosur mbi cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.<sup>97</sup>

"Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në të kundërt nga sa pretendon kërkuesi, gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk ka zgjatur katër vjet por tre vjet e tre muaj. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kjo vonesë ka ardhur si pasojë e jo vetëm të kërkesave që kërkuesi në mënyrë të përsëritur gjatë gjithë procesit ka paraqitur për dorëheqjen e gjyqtarëve apo prokurores por edhe e veprimeve si mosmarrja pjesë në seancat gjyqësore."

Në një rast tjetër, ku pala ankohet për cenimin e një aspekti të veçantë të të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm si pasojë e mosarsyetimit të vendimit për një periudhë mbi 9 muaj nga njoftimi i vendimit.<sup>98</sup>

Krahas argumentimit të servitur nga shumica, është me vlerë të përmenden argumentet e parashtruara nga mendimi i pakicës. Kjo e fundit argumenton se çështja nuk ka qënë veçanërisht e komplikuar, pasi bëhej fjalë për gjykimin e veprës penale të falsifikimit dhe dënimi parashikohej deri në 6 vjet. Gjithashtu, të pandehurit i ishte ndryshuar statusi nga i pafajshëm në fajtor dhe nuk ishte njohur 9 muaj me përmbajtjen e arsyetimit të vendimit. Madje vetë Gjykata Kushtetuese në vendime të tjera ka pranuar që dhe arsyetimi i sintetizuar dhe i shkurtër si ai kolegjit në GJL do të ishte i mjaftueshëm, në kushtet e mungesës totale të një arsyetimi. Pavarësisht kësaj, nuk e konsideron shkelje nga ana e Gjykatës së Lartë mosarsyetimin e vendimit brenda një afati të arsyeshëm. Qendrimi i Gjykatës Kushtetuese në këtë rast krijon premisa që gjykatat e sistemit gjyqësor të zakonshëm, përfshirë këtu Gjykatën e Lartë të përvijojnë me praktikën negative të vonesave në arsyetimin e vendimeve.

### 2.3 Zhvillime të legjislacionit procedural penal në lidhje me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm

97 Gjykata Kushtetuese, Vendim Moskalimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve, Nr. 7/2012

98 Gjykata Kushtetuese, Vendim Nr. 18/2014)

Në analizën e Reformës në Drejtësi u evidentuan një sërë problematikash në lidhje me afatet procedurale, konkretisht në lidhje me afatin e hetimeve paraprake dhe pasojat e kalimit të këtyre afateve, afatet e shkurtra për rivendosjen në afat, mungesën e përcaktimit të afatit kohor të arsyeshëm për shpalljen dhe depozitimin e arsyetimit të vendimit, si dhe me momentin e fillimit të afatit për t'u ankuar etj.<sup>99</sup>

Me hyrjen në fuqi të amendimeve të Kodit të Procedurës Penale me Ligjin 35/2017, u disiplinuan një sërë aspektesh të lidhura me afatet e hetimit dhe gjykimit në një proces penal, si për përfundimin e hetimeve, kohëzgjatjen e paraburgimit, të seancës gjyqësore, diskutimit gjatë procesit dhe marrjen e vendimeve në të trija shkallët e gjykimit. Gjithashtu, amendimet e Kodit të Procedurës penale paraqesin dhe disa risi në lidhje me normimin e rasteve që bëhen shkak për zvarritjen e procesve. Konkretisht, janë parashikuar dispozita për mosparaqitjen e avokatit mbrojtës duke l dhënë të drejtëgjykatës të vendosë gjobë dhe të ngarkojëmbulimin e shpenzimeve,<sup>100</sup>për procedimin me njoftimin në raste të ngutshme,<sup>101</sup>për rivendosjen në afat,<sup>102</sup> dhe për disponimin me vendim menjëherëpër kërkesat paraprake.<sup>103</sup>

"Sipas shumicës, edhe pse Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatin ligjor të parashikuar në ligjin e saj organik për shpalljen e arsyetuar të vendimit gjyqësor të asaj gjykate, fakti që kërkuesi nuk e ka humbur afatin ligjor për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së atij vendimi, nuk e bën procesin ligjor të parregullt.

Krahas këtyre parashikimeve ligjore, Ligji 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale" parashikoi dhe dy institute të rinj, si marrëveshja dhe urdhëri penal. Të dy këto institute synojnë jo vetëm ekonomizimin e procedurave gjyqësore, por edhe shkurtimin e afateve brenda të cilëve shqyrtohen çështjet. I pari zbatohet në rastet e kundërvajtjeve penale në një periudhë jo më vonë se 3 muaj nga regjistrimi i çështjes, përmes të cilit prokurori i kërkon gjykatës miratimin e urdhërit të arsyetuar. Në këto raste aplikohet dënimi me gjobë sa gjysma e dënimit të parashikuar në Kodin Penal si dhe dënime plotësuese. Në lidhje me urdhërin penal, gjykata vendos brenda 10 ditëve nga depozitimi pa praninë e palëve, dhe ankimi mund të bëhet brenda 10 ditëve nga marrja dijani, tek po e njëjta gjykatë.<sup>104</sup>Për sa i përket marrëveshjes, jo mund të lidhet deri në momentin kur nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor,

99 Kuvendi i Shqipërisë, Analiza e Reformës në Drejtësi, fq. 179-181

100 Kodi i Procedurës Penale, nenet 49 paragrafi 5, neni 350

101 Ibid. Neni 133

102 Ibid. Neni 147

103 Ibid. Neni 354

104 Ibid. Nenet 406/a-ç

për vepra penale deri në 7 vjet burgim. Gjykata shqyrton kërkesën për miratimin e marrëveshjes 30 ditë dhe si ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim.<sup>105</sup>Si në rastin e urdhërit penal dhe në rastin e marrëveshjes, gjykata mund të vendosë të pranojë ose refuzojë urdhërin ose marrëveshjen po nuk mund t'i ndryshojë përmbajtjen e udhërit ose kushtet e marrëveshjes.

Përveç Kodit të Procedurave Penale, edhe në Ligjin 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur" parashikohen në mënyrë specifike afate të shpejta për gjykim, duke marrë veçanërisht në konsideratë natyrën e procesit ku në qendër të tij është njëimitur në konflikt me ligjin. Konkretisht në nenin 88 parashikohet si më poshtë:

### Neni 88

1. Të gjitha vendimet dhe veprimet e ndërmarra në bazë të këtij Kodi, që nga fillimi i procesit penal deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kryen në mënyrë të shpejtë, me përparësi, pa vonesa të pajustificuara mbi bazën e interesit më të lartë të të miturit dhe duke respektuar të drejtat e tij.
2. Çdo organ kompetent shqyrton në mënyrë të shpejtë, brenda afateve të caktuara në këtë Kod, dhe me përparësi çështjet e të miturve në konflikt me ligjin, si dhe të çështjeve me të mitur viktimë dhe dëshmitar, duke garantuar që procesi penal, në çdo fazë të tij, të mos përkeqësojë traumën e përjetuar nga i mituri dhe që sistemi i drejtësisë penale për të miturit të sigurojë, sipas rastit, gjithë ndihmën e duhur ndaj të miturit.

Sipas kësaj dispozite, sanksionohen afate specifike procedurale për dërgimin e çështjes në gjykatë, shqyrtimin në shkallë tëparë dhe gjykimin në apel.<sup>106</sup> Ndërsa në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë nuk janë vendosur afate fikse. Mospërcaktimi i afateve të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, e lë disi të paplotë kuadrin e afateve të përshtatura sipas subjektit të procesit penal, konkretisht, të miturit në konflikt me ligjin.

## 3. Afati i arsyeshëm në procesin civil

### 3.1 Nocioni "... të drejta dhe detyrime civile"

Ashtu si edhe për nocionin "akuzë penale", përkufizimi i togfjalëshit "të drejta dhe detyrime civile" përbën një nocion autonomtë interpretuar nga GjEDNJ. Sipas nenit 6 pika 1 e KEDNJ-së standardet e këtij të fundit zbatohen kur kemi të bëjmë me " të drejta dhe detyrime civile", ku ndër to mund të përfshihen çështje civile, tregtare,

<sup>105</sup> Nenet 406/d-f, Rast përjashtimor ndaj rregullit të përgjithshëm të ndalimit të ankimit është kur prokurori mund të bëjë ankim vetëm ndaj vendimit të gjykatë për pushimin e çështjes.

<sup>106</sup> Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, neni 88

familjare, administrative, pune, etj. Përgjithësisht, përcaktues ënëse kemi të bëjmë me të drejta dhe detyrime civile është nëse "veprimi i ankuesit ka implikime me natyrë pasurore".<sup>107</sup>

### 3.2 Llogaritja e afateve në procesin civil

Në llogaritjen e afateve, periudha që do të merret në konsideratë është rregull ajo që nga momenti kur është iniciuar një proces civil nga pala paditëse. Megjithatë, në disa raste, edhe një urdhër i gjykatës ose një procesi ndryshëm nga ai kryesori, mund të shënojë fillimin e periudhës së llogaritur për procesin.<sup>108</sup> Gjithashtu, kriteret e nenit 6 pika 1 mund të zbatohen edhe ndaj procesve të cilat nuk janë tërësisht gjyqësore nga natyra, por megjithatë, janë të lidhura me mbikqyrjen nga një organ gjyqësor. Konkretisht, në rastet e pjestimit të pasurisë para dy noterëve, të urdhëruar dhe miratuar nga gjykata, kohëzgjatja e procedurave para tyre, u mor në konsideratë për të llogaritur afatin e arsyeshëm.<sup>109</sup> Për qëllime të përcaktimit të afatit të zhvillimit të procesit do të merren në konsideratë të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë dhe ato pas gjykimit mbi themelin, si dhe ekzekutimin e vendimit. Më konkretisht do të vlerësohen rethanat e mëposhtme lidhur me nisjen dhe përfundimin e afatit:

Nisja e afatit	Përfundimi i afatit
Data e paraqitjes së kërkesë-padisë Në rastet e mosekzekutimit të një vendimi të formës së prerë: data që vendimi ka marrë formë të prerë <sup>110</sup> Data e konfiskimit të një prone të lidhur Data e paraqitjes së padisë civile në procesin penal Data e paraqitjes së kërkesës për marrjen e masave të përkohshme Data e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore të iniciuara nga aplikanti Data e ndërhyrjes në një proces të pezulluar Data e paraqitjes së të paditurit para gjykatës <sup>111</sup>	Kur vendimi zbatohet plotësisht, pavarësisht natyrës së vendimit gjyqësor apo administrativ <sup>112</sup>

107 Editions Périscope kundër Francës, Aplikimi Nr. 11760/85, 26 March 1992

108 Ivana Roagna, *The right to trial within reasonable time under Article 6 ECHR*, A practical handbook, 2018, fq. 15

109 Ibid. fq. 17

110 Shehu kundër Shqipërisë, Aplikimi Nr. 33704/09, datë 6 tetor 2016

111 Ivana Roagna, *The right to trial within reasonable time under Article 6 ECHR*, A practical handbook, 2018, fq. 16

112 Ramadhi kundër Shqipërisë, Aplikimi Nr. 38222/02, 13 Nëntor 2007

### 3.3 Kriteret për vlerësimin e afateve

Si në një proces penal, ashtu edhe në një proces civil, harku kohor brenda të cilit është realizuar procesi në vetvete nuk përbën shkak detyrimisht përcaktues për zgjatjen e procesit në mënyrë të paarsyeshme. Gjykata vihet përpara detyrimit të vlerësojë të katër kriteret në lidhje me tejkalimin e afateve, bazuar në rrethanat specifike të çdo çështjeje. Duke marrë parasysh specifikat e një gjykimi civil, këto kriteret mund të konkretizohen në vija të përgjithshme si më poshtë:

Kompleksiteti i çështjes	Risku për kërkuesin
Numri i palëve në gjykim, lloji dhe natyra e objektit të padisë Numri i lartë i provave që duhet të shqyrtohen Vlerësimi i mundësisë për të thirrur një ekspert Nevoja e shkëmbimit të informacionit në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja	"Kujdes" i vecantë për subjektet në pozitë vulnerabël <sup>113</sup> Risk me natyrë jo pasurore Risk me natyrës pasurore, si rastet e mosmarrëveshjet e punës <sup>114</sup>
Sjellja e autoriteteve	Sjellja e palës
Veprimet dhe mosveprimet e gjykatave Zvarritje të procesit dhe kthimet për rigjykim si pasojë e gabimeve të gjykatave Refuzim nga organet e ekzekutimit të vendimit për të zbatuar urdhërat e gjykatës	Kërkesa të pabazuara për përjashtimin e gjyqtarit Kërkesë për moskompetencë (pavarësisht se pala nuk mund të fajësohet se përdor mekanizmat proceduralë të garantuar nga legjislacioni në fuqi

### 3.4 Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm në procesin civil nga optika e Gjykatës Kushtetuese

Në rastet e gjykimeve kushtetuese me objekt cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm në një proces civil, Gjykata Kushtetuese ka zbatuar testin e vlerësimit në mënyrë të ngjashme si në rastet e konstatuara në proceset penale. Konkretisht Në Vendimin nr. 12/2012, Gjykata Kushtetuese konstaton:

“Nga dosja se rezultonte se deri në datën e shqyrtimit të kësaj kërkesë në seancë plenare nga Gjykata Kushtetuese, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë zhvilluar gjithsej 36 seanca gjyqësore, ku periudha kohore nga një seancë në tjetrën është haptazi në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor brenda kohës së arsyeshme (shih sesionet e mëposhtme të datave 30.01.2007, 14.03.2007, 27.04.2007, 01.06.2007),

113 Mikulić kundër Kroacisë, Aplikimi Nr. 53176/99 datë 7 shkurt 2012

114 Mishgjoni kundër Shqipërisë, Aplikimi Nr. 18381/05, datë 07 dhjetor 2010



praktikë e cila në vlerësimin e Gjykatës është e bazuar në llojin dhe natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim dhe dispozitat ligjore të Nenit 327 të KKK-së. Gjykata Kushtetuese konstaton se seancat janë shtyrë për shkak të paraqitjes së raportit mjekësor nga gjyqtari, mungesës së njoftimit të palëve për t'u paraqitur në gjykatë, njoftimit të palëve në mungesë, dhënies së kohës për palët për t'u njohur me aktet e çështjes, mungesës së paraqitjes së ekspertit dhe, në disa raste, nuk jepej asnjë shkak për shtyrjen e seancës.

Arsyetimi se numri i lartë i çështjeve në këto gjykata përbën shkakun e vonesës për shqyrtimin e çështjes është i pabazuar. Tejngarkesa me punë e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë dështimin e tyre për të vepruar brenda afatit të caktuar nga ligjvënësi. Përkundrazi, është e detyrë e këtyre të fundit që të marrin masat dhe të gjejnë mjetet për të ndryshuar gjendjen faktike"

Konstatimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm janë shtrirë edhe mbi vonesat në fazën e ekzekutimit të vendimit. Më konkretisht, në vijim të zbatimit të testit të përpunuar nga GjEDNJ për të vlerësuar vonesat në proces ajo shprehet: <sup>115</sup>

"Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës."

### 3.5 Zhvillime të legjislacionit procedural civil në lidhje me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm

Në Analizën e Reformës në Drejtësi, në kuadër të vlerësimit të efikasitetit të gjyqësorit, është nënvizuar se shqyrtimi i çështjeve gjyqësore nga gjykatat e të tria niveleve nuk garanton plotësisht gjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm.<sup>116</sup> Ndër problematikat e evidentuara janë listuar: numri i lartë i çështjeve për gjyqtarë, mosplotësimi i vendeve vakante të gjyqtarëve, delegimi i gjyqtarëve për çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë detyrën, mungesa e mbështetjes

115 Gjykata Kushtetuese, Vendim 12/2013

116 Kuvendi i Shqipërisë, Analiza e Reformës në Drejtësi, fq. 107

sëmjaftueshme me staf administrativ, infrastruktura e papërshtatshme fizike dhe teknologjike, shtyrja e seancave gjyqësore, si pasojë e vështirësive në njoftimine palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në proces, mungesën e parashikimit të formave të ndryshme procedurale të gjykimit për lloje të ndryshme të çështjes, në varësi të rëndësisë së tyre etj.<sup>117</sup> Këtyre problematikave, u shtohen dhe ato të evidentuara rast pas rasti në lidhje me tejzgjatjen e procesve gjyqësore nga GjEDNJ në vendimet për çështjet kundër Shqipërisë.<sup>118</sup> Në vijim të këtyre konstatimeve, në Strategjinë e Reformës në Drejtësi është parashikuar si objektiv specifik "Garantimi i një mjeti ankimi efektiv ndaj vendimeve gjyqësore, rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë së gjyqësorëve duke shmangur zvarritjet e proceseve gjyqësore."<sup>119</sup> Ky objektiv u konkretizua përmes miratimit të amendimeve me Ligjin 38/2017 në Kreun X të Kodit të Procedurës Civile, ku për herë të parë sanksionon një gjykim të posaçëm për shqyrtimin e kërkesave për tejkalimin e afatit të arsyeshëm.

Në përputhje me këtë kre, janë përcaktuar afatet me kalimin e të cilëve subjektit i lind e drejta që të kërkojë jo vetëm konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, por edhe të drejtën e një dëmshpërblimi në përputhje me dëmin e shkaktuar, sipas kufijve minimalë dhe maksimalë të sanksionuar në KPrC. Afatet e parashikuar në KPrC janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme<sup>120</sup>:

	Gjykimet administrative	Gjykimet civile	Gjykimet penale	
			Kundërvajtje	Krime
<b>Shërbimi përbarimor</b>	1 vit	1 vit		
<b>Gjykata e Lartë</b>	(90 ditë? 1 vit? 2 vjet? 6 muaj?)	2 vjet	6 muaj	1 vit
<b>Gjykatë Apeli</b>	1 vit	2 vjet	6 muaj	1 vit
<b>Shkallë e parë</b>	1 vit	2 vjet	1 vit	2 vjet

117 Ibid.

118 *Inter alia*, Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë Aplikimi Nr. 10508/02 datë 23 tetor 2007, Marini kundër Shqipërisë Aplikimi Nr. 3738/02 datë 18 dhjetor 2007, Topallaj kundër Shqipërisë Aplikimi Nr. 32913/03 datë 26 prill 2016, Luli kundër Shqipërisë Aplikimet Nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 and 31355/09 datë 1 prill 2014, Mishgjoni kundër Shqipërisë, Aplikimi Nr. 18381/05, datë 07 dhjetor 2010, Delijorgji kundër Shqipërisë datë 28 prill 2015, Shehu kundër Shqipërisë, Aplikimi Nr. 33704/09, datë 6 tetor 2016

119 Kuvendi, Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, fq. 16

120 KPrC, neni 399/2 para. 1

Nga tabela e mësipërme konstatohet se Ligji 38/2017 ka përshtatur afatet e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në përputhje me natyrën e gjykimit. Në ligj nuk parashikohen afate në lidhje me afatin e përfundimit të gjykimit administrativ në Gjykatën e Lartë. Do t'i mbetet praktikës gjyqësore për t saktësuar nëse në këtë rast do të zbatohen *mutatis mutandis* afatet për gjykimet penale ose civile, apo do të ndiqet një rrugë e mesme e përshtatur me natyrën e gjykimit administrative.

Përpos afateve të parashikuara sa më sipër, KPrC parasheh dhe një hapësirë për të kërkuar konstatimin e cenimit të kësaj të drejte, edhe nëse nuk kanë kaluar këto afate, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen.<sup>121</sup>

KPrC është hartuar në mënyrë të tillë që të mbulojë në mënyrë ezauruese të gjitha format e shpërblimit të drejtë, konkretisht:

- a) njohjen e shkeljes;
- b) marrjen e masave për përsheptimin e procedurave të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit; dhe/ose
- c) shpërblimin e dëmit.

Kërkesa për shpërblimin e dëmit mund të paraqitet vetëm në vijim të vendimit për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurës dhe masa e dëmshpërblimit varion nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, për çdo vit, ose muaj në raport me vitin, përtej afatit të arsyeshëm, pa kaluar vlerën e objektit të padisë dhe caktohet nëlinjë me kriteret e përpunuara nga GjEDNJ.<sup>122</sup>

Në KPrC parashikohen dhe gjykatat kompetente për shqyrtimin e kërkesës si dhe kriteret për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes. Konkretisht, sipas llojit të mosmarrëveshjes, civile, administrative, ose penale, kërkesa gjykohet nga gjykata e një shkalle më të lartë, në rastet se çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje është duke u gjykuar në gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit. Në rastin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, kërkesa do të gjykohet nga një tjetër kolegji i po kësaj gjykate. Ndërsa në rastet e vonesave në ekzekutimin e vendimit kërkesa gjykohet nga

121 KPrC, neni 399/2 para. 2

122 KPrC, neni 399/10 2. Shpërblimi i dëmit bëhet duke mbajtur parasysh:

- a) vështirësinë e procesit, në të cilin është verifikuar shkelja;
- b) sjelljen e trupit gjykues ose përmbaruesit dhe të palëve;
- c) natyrën e interesave në çështje;
- d) vlerën dhe rëndësinë e çështjes në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes ose ekzekutimit, e vlerësuar edhe në raport me kushtet personale të palëve.

gjykata e shkallës së parë, kompetente për ekzekutimin, sipas rregullave në fuqi.<sup>123</sup>Ky gjykim i kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procesit shqyrtohet brenda 45 ditësh, ndërsa shqyrtimi i kërkesë-padisë për shpërblimin e dëmit duhet të përfundojë brenda një afati 3 mujor.<sup>124</sup> Gjithashtu, udhëzimet dhe konkluzionet e gjykatës më të lartë, të dhëna gjatë shqyrtimit të kërkesës, janë të detyrueshme, për gjykatën që shqyrton çështjen në themel ose organin, i cili po kryen ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.<sup>125</sup>

## 4. Afati i arsyeshëm në gjykimin kushtetues

### 4.1 Jurisprudenca e GjEDNj-së

Në jurisprudencën e GjEDNj është konstatuar shpesh se cenimet e nenit 6 pika 1 të KEDNj në sistemin gjyqësor në Shqipërinuk janë shoqëruar me mjete efektive brenda sistemit gjyqësor të brendshëm për të adresuar shkeljet. Pavarësisht se Gjykata Kushtetuese është konsideruar fillimisht si një mjet që duhet të ezaurohet me qëllim shterimin e të gjitha mjeteve juridike të brendshme,<sup>126</sup> në jurisprudencën e mëvonshme të GjEDNj Gjykata Kushtetuese nuk është konsideruar një mjet efektiv që përmbush standardet e KEDNj për përcaktimin e një dëmshpërblimi në rastet e shkeljeve të konstatuara nga Gjykata e Strasburgut. Nëçështjen Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë<sup>127</sup>, GjEDNj shprehet si më poshtë:

"Përveç ankimit kushtetues, sistemi ligjor shqiptar nuk parashikon një mjet ankimor si ato të parashikuara në vendimin e GjEDNj në çështjen Kudla kundër Polonisë, i tillë që mund të shfrytëzohet nga aplikantët në mënyrë që të marrin një dëmshpërblim për zgjatjen e procesve gjyqësore tej afateve të arsyeshëm. Edhe pse teorikisht Gjykata Kushtetuese mund të zhdëmtojë në mënyrë adekuate në lidhje me tejzgjatjen e procesit, Qeveria nuk ka arritur të paraqesë ndonjë rast në të cilin Gjykata Kushtetuese ka vendosur në lidhje me këtë çështje."

123 KPrC, neni 399/6

124 KPrC, neni 399/7

125 KPrC neni 399/11

126 Driza kundër Shqipërisë, Aplikimi Nr. 33771/02 datë 13 nëntor 2007, I njëjti arsyetim është ruajtur dhe në çështjet *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë* Aplikimi Nr. 7352/03, datë 22.08 2006, *Xheraj kundër Shqipërisë* Aplikimi Nr. 37959/02 datë 29.07.2008,

127 Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë Aplikimi Nr. 10508/02 datë 23 tetor 2007

Megjithëse për herë të parë Gjykata Kushtetuese me vendimin 12/2012 pranoi një kërkesë në lidhje me zgjatjen e një procesi gjyqësor tej afateve të arsyeshëm, GjEDNJ në çështjen *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë* nënvizoi si më poshtë:<sup>128</sup>

Përpos konstatimit për karakterin joefektiv të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese në këto raste, kjo e fundit ka vijuar të marrë në shqyrtim këto çështje,<sup>129</sup> megjithëse se nuk ka caktuar asnjë dëmshpërblim. Në vijim të kësaj jurisprudence, parashikimet e amendimeve të Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e posaçëm për konstatimin e shkeljes dhe akordimin e dëmshpërblimit në rastet e tejzgjatjes së procesit brenda një afati të arsyeshëm adresojnë në një masë të konsiderueshme mangësitë e konstatuara nga GjEDNJ për respektimin e afateve në të trija shkallët e gjykimit.<sup>130</sup>

"Gjykata vëren se gjetjet e Gjykatës Kushtetuese në Vendimin nr. 12/2012 ishin me natyrë deklarative. Gjykata nuk akordon ndonjë dëmshpërblim për dëmin jomaterial për zgjatjet e pësuar të aplikantit, dhe as ndonjë perspektivë për përshpejtimin e procesit në fjalë."

Megjithatë, në shumë raste proceset gjyqësore nuk përfundojnë me shpalljen e vendimit nga Gjykata e Lartë. Në bazë të nenit 131 pika f) të Kushtetutës, kushdo mund të ushtrojë një ankim individual kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Sipas GjEDNJ në çështjen *Arribas Antón kundër Spanjës*<sup>131</sup>, neni 6 i KEDNJ-së nuk i detyron shtetet anëtarë të ngrenë gjykata apeli, kasacioni, ose *amparo* (ankimi kushtetues). Megjithatë, shteti që krijon gjykata të tilla, ka detyrimin të sigurojë që individët gëzojnë të drejtat themelore që burojnë nga neni 6 i KEDNJ-së.<sup>132</sup> Pavarësisht, se pranohet natyra *sui generis* e Gjykatës Kushtetuese,<sup>133</sup> në gjykimin e ankimeve individuale ajo nuk mund të cenojë detyrimet për respektimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

128 *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë* Aplikimet Nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 and 31355/09 datë 1 prill 2014

129 Vorpsi, A. dhe Bergmann, J. Ankimi kushtetues individual: Përvoja gjermane dhe perspektiva shqiptare, Manual Praktik, Maluka 2017, fq. 114

130 Kodi i Procedurës Civile, Kreu X

131 *Arribas Antón kundër Spanjës* Aplikimi Nr. 16563/11, datë 20 Janar 2015

132 Adea Pirdeni, Subjektet, legjitimitimi dhe interesi para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Disertacion, fq. 12

133 *Süssman kundër Gjermanisë*, Aplikimi Nr. 20024, datë 16 shtator 1996

### 4.2 Ndryshimet në legjislacionin procedural të gjykimit në Gjykatën Kushtetuese

Në një linjë me ndryshimet në legjislacionin procedural civil, mjetet ankimore për të garantuar respektimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm garantohen tashmë edhe në gjykimin kushtetues. Në amendimet e parashikuara me Ligjin 99/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" u parashikua dhe mekanizmi përkatës në rastet e zgjatjes së procesit nga Gjykata Kushtetuese tej afatit të arsyeshëm. Konkretisht në nenin Neni 71/ç parashikohet se Gjykata Kushtetuese mund të akordojë dëmshpërblim në rastin e gjykimit të zhvilluar tej afatit të arsyeshëm, nëse konstatohet se nga tejkzatja e procesit kërkuesit/kërkueses i janë cenuar të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta. Kjo kërkesë mund të paraqitet jo më shpejt se 1 (një) viti nga shqyrtimi i çështjes, dhe për çdo vit vonesë mund të caktohet një dëmshpërblim në masën 100 000 L. Gjykata Kushtetuese, në çdo rast, vlerëson natyrën e procesit dhe të çështjes, si dhe rrethanat që kanë ndikuar në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë, mund të konsiderohet i plotësuar kuadri ligjor procedural për përshpejtimin e procesve gjyqësore, si dhe akodrimin e dëmshpërblimeve ndaj subjekteve që u është cenuar e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

## Literatura e këshillueshme:

Kujier, M. *The Right to a Fair Trial and the Council of Europe's Efforts to Ensure Effective Remedies on a Domestic Level for Excessively Lengthy Proceedings*, Human Rights Law Review, 13:4(2013), 777-794, pg. 780

Këshilli i Evropës, *Mjetet efektive për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore: Mbështetja e mjeteve të brendshme efektive për zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së*, 2017

Roagna, I. *The right to trial within reasonable time under Article 6 ECHR*, A practical handbook, 2018

Vorpsi, A. dhe Bergmann, J. *The individual Constitutional Complaint: The German experience and the Albanian perspective*, Maluka 2017

# ANEKS

## Një guidë e shkurtër për Artikullin 6 të KEDNJ-së, mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore<sup>134</sup>.

### 4. Ekzekutimi i vendimeve

#### a. E drejta për të ekzekutuar në kohë një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të detyrueshëm

- 162.** Neni 6 § 1 mbron ekzekutimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare dhe të detyrueshme (në ndryshim nga ekzekutimi i vendimeve që mund të jenë objekt shqyrtimi nga një gjykatë më e lartë) (*Ouzounis dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 21).
- 163.** E drejta për ekzekutimin e vendimeve të tilla, të dhëna nga çdo gjykatë, është pjesë përbërëse e «së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës» (*Hornsby kundër Greqisë*, § 40, *Scordino kundër Italisë* (nr.1) [GC], § 196). Në të kundërt, dispozitat e nenit 6 § 1 do të jenë të padobishme (*Burdov kundër Rusisë*, §§ 34 dhe 37).
- 164.** «E drejta për t'iu drejtuar gjykatës» mbron gjithashtu zbatimin e masave të ndërmarra në pritje të miratimit të një vendimi përfundimtar (*Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, § 92). Kështu, prishja e një ndërtese banimi në kundërshtim me urdhrat e përkohshëm të lëshuar nga organet shtetërore përbën shkelje të nenit 6 § 1 (§§ 94-97).

<sup>134</sup> Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights. Right to a fair trial (civil limb), Updated to 30 April 2019, e vlefshme në: [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf), 38-97



165. E drejta për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ka rëndësi të madhe edhe në kontekstin e procedurave administrative (*Sharxi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, § 92). Duke parashtuar një kërkesë për rishikim në gjykatën më të lartë administrative të shtetit, paditësi synon jo vetëm anulimin e vendimit të kundërshtuar, por mbi të gjitha, anulimin e efekteve të tij (p.sh., në lidhje me çështjet mjedisore, *Bursa Barosu Başkanlığı dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 144).
166. Mbrojtja efektive e palës ndërgjyqëse dhe rivendosja e ligjshmërisë, presupozojnë një detyrim nga ana e autoriteteve administrative për të përmbushur vendimin (*Hornsby kundër Greqisë*, § 41, *Kyrtatos kundër Greqisë*, §§ 31-32).
167. Kështu, ndonëse disa vonesa në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohen në rrethana të veçanta, ato nuk mund të jenë të tilla që të dëmtojnë të drejtën e paditësit për ekzekutimin e vendimit (*Burdov kundër Rusisë*, §§ 35-37).
168. Në këtë mënyrë, ekzekutimi duhet të jetë i plotë dhe shterues, jo vetëm i pjesshëm (*Matheus kundër Francës*, § 58, *Sabin Popescu kundër Rumanisë*, §§ 68-76) dhe nuk mund të pengohet, shfuqizohet ose vonohet padrejtësisht (*Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], § 74).
169. Refuzimi i një autoriteti për të marrë parasysh një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë që çon potencialisht në një seri vendimesh për të njëjtin grup procedurash, duke neglizhuar në mënyrë të përsëritur vendimet e dhëna, është gjithashtu në kundërshtim me nenin 6 § 1 (*Turczanik kundër Polonisë*, §§ 49-51).
170. Një vonesë e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi të detyrueshëm mund të shkelë Konventën. Arsyetimi i një vonese të tillë duhet të përcaktohet duke pasur parasysh në veçanti kompleksitetin e procedurave të ekzekutimit, sjelljen e vetë aplikantit dhe atë të autoriteteve kompetente, si dhe shumën dhe natyrën e vendimit gjyqësor (*Raylyan kundër Rusisë*, § 31).
171. Për shembull, Gjykata konstatoi se duke neglizhuar për më shumë se pesë vjet marrjen e masave të nevojshme për të përmbushur një vendim gjyqësor të detyrueshëm, autoritetet kombëtare kishin privuar dispozitat e nenit 6 § 1 nga çdo efekt i dobishëm (*Hornsby kundër Greqisë*, § 45).
172. Në një rast tjetër, periudha prej nëntë muajsh që iu desh autoriteteve për të zbatuar një vendim, u cilësua si e paarsyeshme në lidhje me rrethanat (*Moroko kundër Rusisë*, §§ 43-45).
173. Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt sipas

- nenit 6 § 1, për shkak të refuzimit të autoriteteve, për një periudhë prej rreth katër vjetësh, për të përdorur ndihmën e policisë në zbatimin e një urdhri për posedim kundër qiramarrësit (*Lunari kundër Italisë*, §§ 38-42), dhe për shkak të pezullimit të ekzekutimit - për më shumë se gjashtë vjet - nga ndërhyrja e legjislaturës duke vënë në pikëpyetje një urdhër të gjykatës për dëbimin e qiramarrësit, i cili u privua nga të gjitha efektet e dobishme të dispozitave ligjore të kontestuara (*Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], §§ 70 dhe 74).
- 174.** Një person i cili ka marrë një vendim kundër shtetit në fund të procedurave gjyqësore nuk mund të pritet që të sjellë procedura të ndara për ekzekutimin (*Burdov kundër Ruisë* (nr.2), § 68, *Sharxi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, § 93). Barra për të siguruar ekzekutimin e një vendimi kundër Shtetit qëndron mbi autoritetet shtetërore (*Yavorivskaya kundër Ruisë*, § 25), duke filluar nga data në të cilën ai bëhet i detyrueshëm dhe i zbatueshëm (*Burdov kundër Ruisë* (nr.2), § 69). Kjo do të thotë se pagesa e vonuar e shumëve që i takojnë aplikantit, pas procedurave të ekzekutimit, nuk mund të justifikojë dështimin e vazhdueshëm të autoriteteve kombëtare për të përmbushur një vendim dhe gjithashtu nuk siguron dëmshpërblimin e duhur (*Scordino kundër Italisë* (nr.1) [GC], § 198).
- 175.** Një pale paditëse të suksesshme mund t'i kërkohet që të ndërmarrë hapa të caktuara procedurale për të lejuar ose përshpejtuar ekzekutimin e vendimit. Megjithatë, kërkesa e bashkëpunimit nga kreditori nuk duhet të tejkalojë atë që është rreptësisht e nevojshme dhe njëkohësisht, nuk i lehtëson autoritetet nga detyrimet e tyre (*Burdov kundër Ruisë* (nr.2), § 69).
- 176.** Gjykata konstatoi se qëndrimi i autoriteteve për të identifikuar ankuesin si përgjegjës për fillimin e procedurës përmbartimore, në lidhje me një vendim të zbatueshëm në favor të tij, së bashku me mospërfilljen e gjendjes së tij financiare, përbënte një barrë të tepruar dhe kufizonte të drejtën e tij të aksesit në gjykatë, deri në masën e dëmtimit të thelbit të asaj të drejte (*Apostol kundër Gjeorgjisë*, § 65).
- 177.** Pala ndërgjyqëse nuk mund të privohet nga përfitimi brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi përfundimtar, i cili i jep atij kompensim për dëmin (*Burdov kundër Ruisë*, § 35) ose strehim (*Teteriny kundër Ruisë*, §§ 41-42), pavarësisht nga kompleksiteti i procedurave të brendshme të ekzekutimit apo sistemit buxhetor të Shtetit. Nuk është e lejuar për një autoritet shtetëror të përmendë mungesën e fondeve apo burimeve të tjera, si justifikim për mos dëmshpërblimin e një pale (*Burdov kundër Ruisë*, § 35, *Amat-G Ltd dhe Mëbaghishvili kundër Gjeorgjisë*, § 47, *Scordino kundër Italisë* (nr.1) [GC], §

- 199). Gjithashtu, mungesa e akomodimit alternativ nuk është një arsytim i vlefshëm për mospërbushjen e një detyrimi (*Prodan kundër Moldavisë*, § 53, *Tchokontio Happi kundër Francës*, § 50, *Burdov kundër Rosisë* (nr.2), § 70)).
- 178.** Koha e nevojshme që autoritetet të përmbushin një vendim që urdhëron pagesën e një shpërblimi monetar duhet të llogaritet nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar dhe i ekzekutueshëm, deri në datën e pagesës së shumës së dhënë. Një vonesë prej dy vjetësh dhe një muaji në pagimin e një dëmshpërblimi është në kundërshtim me kërkesat e Konventës, përveç rasteve kur ka ndonjë rrethanë për ta justifikuar atë (*Burdov kundër Rosisë* (nr.2), §§ 73-76 dhe 83).
- 179.** Argumenti që autoritetet vendore gëzojnë autonomi sipas ligjit të brendshëm është i papërfillshëm, duke pasur parasysh parimin e përgjegjësisë ndërkombëtare të Shtetit sipas Konventës (*Société de gestion du port de Campoloro dhe Société fermière de Campoloro kundër Francës*, § 62).
- 180.** Duhet të bëhet një dallim midis rasteve kur debitorë janë autoritetet shtetërore (*Burdov kundër Rosisë* (nr.2), §§ 68-69, 72 et seq.) dhe kur debitor është një individ, duke qenë se detyrimi sipas Konventës ndryshon sipas statusit të debitorit.
- 181.** Një individ që ka marrë një vendim kundër një autoriteti publik, normalisht nuk i kërkohet të sjellë procedura të ndara përbarimi. Gjykata ka konstatuar se nuk është e përshtatshme të kërkohet nga një individ, i cili ka fituar një çështje kundër shtetit në procedura ligjore, të nisë procedurat e përbarimit (*Metaxas kundër Greqisë*, § 19, *Kukalo kundër Rosisë*, § 49). Mjafton që ky i fundit të njoftojë autoritetin e shtetit në fjalë në mënyrë të përshtatshme (*Akashev kundër Rosisë*, § 21) ose të kryejë disa hapa proceduralë të natyrës formale (*Kosmidis dhe Kosmidou kundër Greqisë*, § 24).
- 182.** Kur debitori është një individ privat, përgjegjësia nuk mund t'i faturohet shtetit për shkak të mos pagesës të një borxhi të detyrueshëm, si rezultat i paaftësisë paguese të një debitori «privat» (*Sanglier kundër Francës*, § 39; *Ciprová kundër Republikës Çeke* (vendim),

*Cubanit kundër Rumanisë* (vendim)). Megjithatë, shteti ka një detyrim pozitiv për të organizuar një sistem për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare për mosmarrëveshjet ndërmjet personave privatë, i cili është efektiv si në teori, ashtu edhe në praktikë (*Fuklev kundër Ukrainës*, § 84). Prandaj, shteti mund të jetë përgjegjës nëse autoritetet publike të përfshira në procedurat e përbarimit dështojnë të tregojnë kujdesin e duhur, apo ndalojnë ekzekutimin (ibid., § 67). Masat e marra nga

autoritetet kombëtare për të siguruar zbatimin e vendimit duhet të jenë adekuate dhe të mjaftueshme për këtë qëllim (*Ruianu kundër Rumanisë*, § 66), duke pasur parasysh detyrimet e tyre në ekzekutim, duke qenë se janë ata që ushtrojnë autoritetin publik (ibid., §§ 72-73, *Sekul kundër Kroacisë* (vendim), §§ 54-55).

183. Kështu, për shembull, Gjykata vendosi që mos marrja e sanksioneve në lidhje me dështimin e një pale të tretë (private) për të bashkëpunuar me autoritetet e autorizuar për zbatimin e vendimeve përfundimtare, bën që autoritetet kombëtare të privojnë dispozitat e nenit 6 § 1 nga të gjitha efektet e dobishme (*Pini dhe të tjerët kundër Rumanisë*, §§ 186-88, ku institucioni privat në të cilin jetonin dy fëmijë kishte penguar për më shumë se tre vjet ekzekutimin e urdhrave për adoptimin e fëmijëve).
184. Megjithatë, aty ku shteti ka ndërmarrë të gjitha hapat e parashikuar nga ligji për të siguruar që një individ privat të respektojë një vendim, ai nuk mund të jetë përgjegjës për refuzimin e debitorit për të përmbushur detyrimet e tij (*Fociac kundër Rumanisë*, §§ 74 dhe 78).
185. Së fundmi, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës gjithashtu mbron të drejtën e aksesit në procedurat e ekzekutimit, d.m.th., të drejtën për të filluar procedurat e përmbarrimit (*Apostol kundër Gjeorgjisë*, § 56).

### b. E drejta për të mos rishqyrtuar një vendim gjyqësor të formës së prerë

186. E drejta për një seancë verbale duhet të interpretohet në dritën e sundimit të ligjit. Një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike (*Okyay dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 73), i cili ndër të tjera kërkon që kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në diskutim (*Brumărescu kundër Rumanisë* [GC], § 61, *Agrokompleks kundër Ukrainës*, § 148).
187. Sistemet gjyqësore të karakterizuara nga vendime që mund të rishqyrtohen pafundësisht dhe në rrezik që të mënjanoen vazhdimisht janë në kundërshtim me nenin 6 § 1 (*Sovtransavto Holding v. Ukrainës*, §§ 74, 77 dhe 82, lidhur me një procedurë proteste, ku Kryetari i Tribunalit Suprem të Arbitrazhit, Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësit e tyre kishin kompetencë të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar vendimet e formës së prerë, duke paraqitur një kundërshtim sipas procedurës së shqyrtimit mbikëqyrës).

- 188.** Shqyrtimi i vendimeve në këtë mënyrë nuk është i pranueshëm, qoftë nga gjyqtarët dhe anëtarët e ekzekutivit (*Tregubenko kundër Ukrainës*, § 36), ashtu edhe nga autoritetet jo gjyqësore (*Agrokompleks kundër Ukrainës*, §§ 150- 51).
- 189.** Një vendim përfundimtar mund të vihet në diskutim vetëm kur kjo është bërë e nevojshme nga rrethana të një karakteri thelbësor dhe bindës, si p.sh. gabimi gjyqësor

(*Ryabykh kundër Ruisisë*, § 52, shih gjithashtu *Vardanyan dhe Nanushyan kundër Armenisë*, § 70, dhe krahaso me *Trapeznikov dhe të tjerët kundër Ruisisë*, në të cilin procedura e shqyrtimit mbikëqyrës, e zbatuar me kërkesë të palëve, nuk ka shkelur parimin e sigurisë juridike, §§ 39-40).

### c. Njohja e ndërsjellë dhe ekzekutimi i vendimeve të nxjerra nga gjykatat e huaja ose institucione të tjera në Bashkimin Evropian

- 190.** Vendimi për të zbatuar një gjykim të huaj (exequatur) nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 6 § 1, nëse është marrë pa garantuar mundësinë efektive të ushtrimit të një ankimi, në lidhje me parregullsinë e procedurave të këtij gjykimi, si në shtetin e origjinës ashtu edhe në shtetin e adresuar. Gjykata gjithmonë ka zbatuar parimin e përgjithshëm që një gjykatë që shqyrton një kërkesë për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të huaj, nuk mund ta pranojë kërkesën pa kryer më parë një rishqyrtim të atij vendimi, në dritën e garancive të një procesi të rregullt gjyqësor; masa e rishqyrtimit mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit (*Pellegrini kundër Italisë*, § 40).
- 191.** Rasti *Avotins kundër Letonisë* [GC] ka të bëjë me ekzekutimin e një vendimi të marrë në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian. Praktika gjyqësore e Gjykatës lidhur me prezumimin e mbrojtjes ekuivalente të të drejtave themelore brenda Bashkimit Evropian (i njohur si «prezumimi i Bosforit») u aplikua për herë të parë tek mekanizmat e njohjes së ndërsjellë, të bazuara në parimin e besimit të ndërsjellë midis shteteve anëtare të BE. Rasti në Letoni lidhet me ekzekutimin e një vendimi të dhënë në një vend tjetër (Qipro) në mungesë të debitorit. Gjykata parashtroi parime të përgjithshme mbi këtë çështje dhe tregoi rrethanat në të cilat supozimi mund të kundërshtohet (veçanërisht §§ 115-17). Duke zbatuar këto parime, Gjykata nuk konstatoi se mbrojtja e të drejtave themelore ishte aq e mangët sa të kundërshtonte prezumimin e mbrojtjes ekuivalente.



Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



<http://horizontal-facility-eu.coe.int>